



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 590, datë 18.10.2023

PËR
VLERËSIMIN ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARES {...}, ME QËLLIM
GRADIMI, PËR PERIUdhËN E VLERËSIMIT 2013-2016

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 95 dhe 171 pika 5, të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Vendimet e Këshillit të Lartë Gjyqësor, nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, pasi shqyrtoi “Projektraportin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares {...}, me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, i hartuar nga relatore znj. Yllka Rupa,

V E N D O S I :

1. Miratimin e “Raporti i vlerësimit etik dhe profesional, me qëllim gradimi, të gjyqtares {...}, për periudhën e vlerësimit 2013-2016”, duke e vlerësuar atë si më poshtë:
 - A. Aftësitë profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - B. Aftësitë organizative – “Shkëlqyeshëm”;
 - C. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale – “Shkëlqyeshëm”;
 - D. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional – “Shkëlqyeshëm”.Niveli i përgjithshëm i vlerësimit – “Shkëlqyeshëm”.
2. Raporti i vlerësimit i miratuar sipas pikës 1, i bashkëngjitet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 15 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe ekstrakti i tij publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor në përputhje me nenin 95 pika 9 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

KOMISIONI I VLERËSIMIT TË ETIKËS DHE VEPRIMTARISË PROFESIONALE

ANALIZA E TË DHËNAVE TË MARRA NGA BURIMET E VLERËSIMIT DHE PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI

1. AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtares {...} në drejtim të aspekteve të njohurive ligjore dhe arsytimit të vendimit, vlerësuesi përqendrohet në metodologjinë e përgjithshme të punës së gjyqtares bazuar në dosjet e përzgjedhura dhe nuk vlerëson meritat ligjore të vendimeve individuale, të cilat përcaktohen vetëm në kuadër të një procesi ankimi. Aftësia profesionale e gjyqtares pikëzohet sipas dy aspekteve, njohuritë ligjore dhe arsytimi ligjor, të cilët ndahen në disa nën tregues.

1.A. NJOHURITË LIGJORE

1.A.A AFTËSIA PËR TË IDENTIFIKUAR NATYRËN E ÇËSHTJES, LIGJIN E ZBATUESHËM DHE/OSE KONFLIKTIN E NORMAVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “...Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, ajo e analizon normën administrative të zbatueshme (shih dokumenti 1 dhe dosja 2). Evidenton pjesë të ndryshme të legjislacionit (K.Punës, apo ligj i specifik) për të identifikuar se cila prej tyre duhet të aplikohet, duke analizuar konfliktin e normave në raport me natyrën e mosmarrëveshjes (shih dosjet 3, 4 dhe 5)”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

- ***Në lidhje me përshkrimin e fakteve të çështjes:***

Referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja përshkruan faktet dhe rrethanat e çështjes, në përputhje me provat e lejuara dhe të marra gjatë shqyrtimit në shkallë të parë, por edhe gjatë gjykimit në apel, në ato çështje kur gjykata e apelit e shqyrton çështjen në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka (mosmarrëveshjet me objekt aktet nënligjore normative).¹

Duke u nisur nga mënyra se si janë paraqitur rrethanat e çështjes në vendimet e analizuara, faktet parashtrihen gjithmonë në pjesën e parë të pjesës përshkruese-arsyetuese të vendimit. Edhe pse në vendimet nuk rezulton një nën-pjesë e titulluar “Rrethanat e faktit”, referuar mënyrës së përshkrimit të rrethanave të çështjes, në përputhje dhe duke i integruar me provat e administruara, faktet evidentohen lehtësisht. Në çdo vendim gjyqësor evidentohet kujdesi i duhur që gjyqtarja tregon për cilësimin e saktë të veprimeve që përbëjnë fakte juridike, pavarësisht nëse përcaktimi i gabuar ose jo i faktit, ka përbërë ose jo shkak ankimi. Kjo, sepse përcaktimi i saktë i faktit lidhet prej saj në çdo rast me analizimin e shkaqeve të ankimit dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes.

- ***Identifikimi i natyrës së çështjes:***

Nga identifikimi dhe përshkrimi i saktë i faktit juridik, gjykata krijon idenë e saj rreth natyrës së marrëdhënies juridike për shkak të së cilës ka lindur mosmarrëveshja midis palëve. Gjyqtarja i jep rëndësinë e duhur përcaktimit të saktë të natyrës së marrëdhënies juridike të krijuar ndërmjet palëve, pasi ky përcaktim ka lidhje të drejtpërdrejtë me kompetencën lëndore dhe përbën një nga shkaqet për prishjen e vendimit të shkallës së parë, konform nenit 54 paragrafi i parë, shkronja “a” të ligjit 49/2012 dhe nenit 467 paragrafi i parë, shkronja “a” të K.Pr.Civile. Në këtë kontekst, nga vlerësimi i vendimeve të përzgjedhura nga vetë gjyqtarja dhe atyre të përzgjedhura me short, vihet re që edhe pse jo gjithmonë në mënyrë të drejtpërdrejtë, të shprehur në mënyrë eksplicite, gjyqtarja e përcakton natyrën e çështjes objekt shqyrtimi.

- ***Në drejtim të përcaktimit të ligjit të zbatueshëm:***

Referuar burimeve të vlerësimit evidentohet se gjyqtarja ka identifikuar dhe përcaktuar qartë ligjin e zbatueshëm, duke evidentuar dhe herë pas here cituar, në përmbajtjen e vendimit, dispozitat e ligjit procedural, të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit të Procedurës Civile, të Kodit Civil, të Kodit të Punës dhe dispozita të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme, që gjejnë zbatim në çështjen konkrete.

Sa i përket ligjit procedural, gjyqtarja ka referuar dhe cituar në disa raste, si pjesë e arsytimit të vendimit, nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile në funksion të legjitimitetit aktiv të paditësit në ngritjen e padisë së shqyrtuar me vendimin objekt ankimi;² nenin 50/ç të ligjit nr. 49/2012 dhe nenin 467/e, ë të K.Pr.Civile lidhur me shkaqet e prishjes së vendimit të gjykatës së shkallës së parë,³ nenin 16 të K.Pr.Civile, në lidhje me të drejtën e gjykatës për të bërë një cilësim të saktë të

¹ Vendimi nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

² Vendimi nr.2057, datë 26.04.2014 dhe vendimi nr. 914, datë 19.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

³ Vendimi nr. 397, datë 26.02.2014 dhe nr.914, datë 19.03.2014 të Gjykatës Administrative të Apelit.

fakteve dhe të mosmarrëveshjes objekt gjykimi, pa e lidhur atë me mënyrën e prezantimit të palëve;⁴ nenin 6 të K.Pr.Civile në lidhje me rolin e gjykatës dhe kufijtë e shqyrtimit të çështjes në gjykimin civil, nenin 10/b të ligjit 49/2012, në lidhje me kompetencën funksionale të gjykatës administrative të apelit, nenin 7 të ligjit 49/2012, në lidhje me juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore të gjykatës, nenin 15 të ligjit 49/2012, në lidhje me interesin e ligjshëm në ngritjen e padisë, nenin 18/3 të ligjit 49/2012, në lidhje me afatin e kundërshtimit të aktit nënligjor normativ; nenin 27 të ligjit 49/2012, lidhur me pasojat e mosparaqitjes së provave përpara seancës së parë gjyqësore;⁵ nenin 37/1 të ligjit nr. 49/2012, në lidhje me kufijtë e shqyrtimit nga gjykata mbi ligjshmërinë e veprimit administrativ;⁶ etj.

Sa i përket dispozitave të ligjit material të zbatueshëm, gjyqtarja ka identifikuar, referuar, dhe në disa raste ka cituar dispozitat të Kodit të Procedurave Administrative, të Kodit Civil dhe të ligjeve dhe akteve nënligjore të posaçme që gjejnë zbatim në çështjet objekt shqyrtimi. Konkretisht, në vendimet e analizuara gjyqtarja referon dispozitat të ligjit material, si më poshtë:

- dispozita të ligjit nr.7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimet e pasurive të paluajtshme”, lidhur me të drejtat e regjistruarit, si dhe zgjidhjen e pretendimeve për regjistrimin fillestar;⁷
- nenin 116 të K.Pr.Administrative dhe dispozitat e ligjit nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, etj; nenin 118 të K.Pr.Administrative lidhur me pavlefshmërinë relative të aktit administrativ, dispozitat e ligjit 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit” i ndryshuar, dispozitat e ligjit 8652, datë 31.07.2000, “Për organizmin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” i ndryshuar;⁸
- nenin 138 të K.Pr.Administrative dhe dispozitat e ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”;⁹
- nenin 140 të K.Punës, në lidhje me llojin e kontratës së punës me apo pa afat, nenin 143 të K.Punës, në lidhje me afatin e njoftimit për përfundimin e marrëdhënies së punës, nenin 144 të K.Punës në lidhje me procedurën e zgjidhjes së kontratës së punës, nenin 145 të K.Punës, në lidhje me institutin e shpërblimit për vjetërsi dhe nenin 153 të K.Punës, në lidhje me shkaqet e pajustificuara të zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si norma relevante për zgjidhjen e mosmarrëveshjes objekt gjykimi;¹⁰
- nenin 193 të Kodit Civil dhe nenin 75/2 të ligjit nr. 33/2012, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar, lidhur me regjistrimin e pasurive të paluajtshme,¹¹ etj.

Në vendimin nr. 4, datë 27.01.2016, gjyqtarja ka identifikuar dhe referuar si norma të zbatueshme nenet 109, 113 dhe 118 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhur me nxjerrjen e akteve nënligjore vetëm nga organet e parashikuara në Kushtetutë, mbi bazën e autorizimit të shprehur në ligj dhe vetëm për çështje që ligji përcakton se duhen rregulluar me akt nënligjor.

Sa i përket aspektit të evidentimit të konfliktit të normave, në vendimet e analizuara nuk rezultojnë të jetë evidentuar ndonjë rast i konfliktit të normave me karakter procedural ose material, kushtëzuar kjo edhe nga natyra e çështjeve.

⁴ Vendimi nr. 2595, datë 15.09.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

⁵ Vendimi nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

⁶ Vendimi nr.814, datë 20.04.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit

⁷ Vendimi nr. 2057, datë 26.05.2014 dhe vendimi nr. 1039, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

⁸ Vendimi nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

⁹ Vendimi nr.64, datë 16.11.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit.

¹⁰ Vendimi nr. 1025, datë 18.05.2015, vendimi nr. 663, datë 25.03.2016, vendimi nr.1989, datë 21.05.2014 dhe vendimi nr. 2420, datë 16.11.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

¹¹ Vendimi nr. 1525, datë 07.05.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në identifikimin e qartë dhe të saktë të fakteve të çështjes, identifikimin e normës/normave konkrete procedurale dhe/ose materiale që gjejnë zbatim, citimin dhe analizën e normave respektive, në funksion të zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin e “Aftësia për të identifikuar natyrën e çështjes, ligjin e zbatueshëm dhe/ose konfliktin normave” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.*

1.A.B. AFTËSIA PËR TË INTERPRETUAR LIGJIN NË ZGJIDHJEN E ÇËSHTJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, është konstatuar se ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye të qarta për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Në disa raste, ajo e analizon normën administrative të zbatueshme (shih dokumenti 1 dhe dosja 2). Evidenton pjesë të ndryshme të legjislacionit (K.Punës, apo ligj i specifik) për të identifikuar se cila prej tyre duhet të aplikohet, duke analizuar konfliktin e normave në raport me natyrën e mosmarrëveshjes (shih dosjet 3, 4 dhe 5). Kur është rasti, në funksion të nxjerrjes së konkluzioneve për zbatimin e ligjit, ajo përdor referenca në jurisprudencën e Gjykatës së Lartë dhe Gjykatës Kushtetuese (shih dokumentat 2, 3, si dhe dosjet 2 dhe 4) dhe të drejtën ndërkombëtare (shih dokumentet 1, 3 dhe dosjen 4). Nga 3 dokumentet e përzgjedhura prej tij dhe 5 dosjet gjyqësore konfirmohen njohuri në të drejtën administrative, ku bien në sy regjistrimi i pasurive të paluajtshme (shih dokumentin 2 dhe dosjen 1), pavlefshmëria e akteve administrative të organeve të qeverisjes vendore në lidhje me taksat vendore (shih dokumentin 1), aktet administrative në lidhje me detyrimet tatimore të papaguara (shih dokumentin 3, dosjen 3), marrëdhëniet e punës (shih dosjet 4 dhe 5) dhe nxjerrja e akteve administrative për të drejtën e pensionit (shih dosjen 3). Në 5 dosjet e vëzhguara gjykimi i çështjes është bërë në dhomë këshillimi, mbi bazë të dokumentave, pa praninë e palëve”.*

Në vendimet burim vlerësimi, identifikimi i normës juridike (*kryesisht asaj materiale*) si ligj i zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes, bëhet në shërbim të analizës juridike të fakteve objekt shqyrtimi, duke sjellë si rrjedhojë logjike konkluzionin e arritur nga gjyqtarja lidhur me zbatimin e saj. Normat ligjore citohen duke u shoqëruar me interpretimin e tyre dhe aplikimin mbi faktet e çështjes dhe në asnjë rast citimi i dispozitave nuk bëhet pa e shoqëruar me ndërthurjen e interpretimit të tyre mbi faktin konkret, ose konkluzionin e arritur në shërbim të të cilit ato citohen. Interpretimi i dispozitave materiale bëhet nga ana e gjyqtarës sipas mënyrës së interpretimit të tyre, në funksion të analizës juridike dhe të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Në këtë kontekst, konstatohet se gjyqtarja kryesisht interpreton normën ligjore konkrete ndaj faktit juridik të nxjerrë nga analiza e provave të shqyrtuara, duke nxjerrë konkluzionin e saj në lidhje me zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

- Në lidhje me interpretimin e ligjit material të zbatueshëm:

Përgjithësisht, interpretimi i normës juridike bëhet jo vetëm në aspektin teorik të saj, duke identifikuar në mënyrë specifike qëllimin, funksionin, apo duke përcaktuar kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen në mënyrë kumulative që të gjejë zbatim pretendimi dhe kërkimi i palës, por në përputhje me faktin dhe provat e lejuara dhe të marra në shqyrtim. Konkretisht, në mënyrë më specifike, në disa prej vendimeve gjyqësore burim vlerësimi evidentohet të jenë interpretuar dispozitat ligjore dhe nënligjore lidhur me:

- pavlefshmërinë relative të akteve administrative, sipas nenit 118 të K.Pr.Administrative, si dhe interpretimin e nenit 116 të K.Pr.Administrative, me qëllim hetimin e ekzistencës së shkaqeve ligjore të pavlefshmërisë absolute të akteve administrative;¹²
- kushtet e mungesës së legjitimitetit aktiv të palës paditëse, pasi në kuptim të dispozitave të ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, personi i interesuar që vendos në lëvizje zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, është personi që heq të drejta nga titulli i pronësisë që kërkohet të regjistrohet.¹³
- interesin publik për mospezullimin e akteve administrative që lidhen me mbledhjen e tatimeve, sipas nenit 138 të K.Pr.Administrative, si dhe dispozitave të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.¹⁴
- interpretimin literal të dispozitës materiale (*nenit 143 të K.Punës*) dhe rrethanave të faktit. Gjyqtarja konkludon se zgjidhja e kontratës së punës është kryer në mënyrë të menjëhershme, pa respektuar afatin e njoftimit, e për pasojë, në lidhje me këtë mënyrë përfundimi, referenca ligjore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes orientohet drejt normave materiale, neneve 153 dhe 155 të K.Punës, për të përcaktuar nëse shkaqet e zgjidhjes e justifikojnë këtë mënyrë përfundimi të marrëdhënies së punës me paditësin. Gjyqtarja interpreton dispozitën përkatëse (*nenin 153 të K.Punës*) duke analizuar kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen në mënyrë kumulative, në përputhje me faktet, që të legjitimojnë punëdhënësin që të zgjidhë në mënyrë të menjëhershme kontratën e punës me punëmarrësin. Më tej, gjyqtarja analizon nenin 144 të K.Punës, për të verifikuar nëse nga ana e punëdhënësit është respektuar procedura e zgjidhjes së marrëdhënies së punës, si dhe interpreton nenin 145 të K.Punës, me qëllim konkludimin

¹² Vendimi nr. 4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

¹³ Vendimi nr.2057, datë 26.05.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit.

¹⁴ Vendimi nr. 64, datë 16.1.2015 i Gjykatës Administrative të Apelit.

nëse plotësohen kushtet në mënyrë kumulative në mënyrë që punëmarrësi të përfitojë shpërblimin për vjetërsi në punë.¹⁵

Në lidhje me dispozitat procedurale, gjyqtarja i ka interpretuar ato në rastet e mëposhtme:

- interpreton nenet 31 dhe 32 të K.Pr.Civile, në funksion të analizimit të konceptit të legjitimitetit aktiv. Interpretimi i këtyre normave shoqërohet edhe me citimin e përmbajtjes së vendimit unifikues nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;¹⁶
- interpreton nenet 7 dhe 10/b të ligjit nr. 49/2012, për të konstatuar kryesisht kompetencën funksionale, juridiksionin gjyqësor dhe kompetencën lëndore për shqyrtimin e çështjes, si edhe nenin 15 të ligjit 49/2012, lidhur me të drejtën e ngritjes së padisë që ka çdo subjekt që i është cenuar një e drejtë apo interes i ligjshëm nga një veprim apo mosveprim i organit publik, apo për shkak të ndërhyrjeve të paligjshme të organit publik, që nuk kanë formën e aktit administrativ.¹⁷

Në lidhje me zbatimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës evidentohet se gjyqtarja në disa raste, gjatë interpretimit të ligjit të zbatueshëm në zgjidhjen e çështjes, përmend dhe/ose zbaton parimet e përgjithshme të së drejtës, fakt i cili evidentohet duke i përmendur ato shprehimisht dhe në raste të tjera, duke iu referuar kontekstit të arsyetimit dhe analizës ligjore të vendimit. Gjyqtarja referon dhe zbaton *parimin e rezervës ligjore dhe parimin e epërsisë së ligjit*, që në rastin konkret, gjyqtarja argumenton se mbi bazën e këtyre dy parimeve, aktet nënligjore nxirren vetëm nga organet e parashikuara në Kushtetutë, mbi bazën e autorizimit të shprehur në ligj dhe vetëm për çështjet që ligji përcakton se duhen rregulluar me akt nënligjor.¹⁸

- ***Në lidhje me aftësinë e gjyqtarës për të përdorur jurisprudencën relevante.***

Në vendimet e administruara evidentohet se gjyqtarja përdorur jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese dhe jurisprudencën Unifikuese të Gjykatës së Lartë. Konkretisht:

- në vendimin nr.1525, datë 07.05.2014, në lidhje me konkluzionin se shkaqet që kanë diktuar vendosjen e kufizimit mbi pasurinë e paluajtshme kanë qenë inekzistente, gjyqtarja referon vendimin nr. 17, datë 23.04.2010, të Gjykatës Kushtetuese;
- në vendimin nr. 64, datë 16.11.2015, rezulton se nga ana e gjyqtarës është cituar dhe zbatuar në drejtim të vlerësimit për rrëzimin e kërkesës për marrjen e masës së përkohshme për sigurimin e padisë, vendimi unifikues nr. 10, datë 24.03.2004, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- në vendimin nr. 2057, datë 26.05.2014, lidhur me kushtet e mungesës së legjitimitetit aktiv të palës paditëse, gjyqtarja ka çmuar të theksojë praktikën unifikuese të Gjykatës së Lartë, vendimin unifikues nr. 1, datë 06.01.2009, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë; etj.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në interpretimin e ligjit procedural dhe material, në shërbim të

¹⁵ Vendimi nr. 1989, datë 21.05.2014, vendimi nr. 2420, datë 16.11.2015, vendimi nr. 663, datë 25.03.2016 dhe vendimi nr. 1025, datë 18.05.2015 të Gjykatës Administrative të Apelit.

¹⁶ Vendimi nr. 914, datë 19.03.2014 dhe vendimi nr.2057, datë 26.05.2014 i Gjykatës Administrative të Apelit.

¹⁷ Vendimi nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

¹⁸ Vendimi nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit.

konkluzioneve të arritura në lidhje me çështjen dhe kur është e nevojshme, në mbështetje të arsytimit të vendimeve, identifikon dhe zbaton praktikën gjyqësore unifikuese, praktikën e Gjykatës Kushtetuese, si dhe zbaton dhe respekton parimet e së drejtës.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Aftësia për të interpretuar ligjin në zgjidhjen e çështjes” është “Shumë lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

1.B. ARSYETIMI LIGJOR

1.B.A. QARTËSIA, KONCIZITETI DHE KUPTUESHMËRIA E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “*Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi në arsyetimin ligjor. Vendimet gjyqësore përfundimtare të arsyetuara prej saj, janë të qarta dhe të kuptueshme. Respekton rregullat e drejtshkrimit, në funksion të qartësisë së arsytimit të vendimit gjyqësor*”.

Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues evidentohet se vendimet gjyqësore janë të qarta dhe të kuptueshme, duke u bërë të kuptueshëm edhe për një lexues të arsyeshëm, jo vetëm për njohësit e ligjit. Nuk evidentohet përdorimi i fjalëve që cenojnë integritetin e personit, si dhe shmang përdorimin e fjalëve fyese apo denigruese. Përdor përgjithësisht të gjitha shkronjat e alfabetit shqip. Gjuha teknike përdoret në mënyrë korrekte dhe konsistente, vetëm në rastet kur është i pashmangshëm përdorimi i saj, sikundër parashikohet shprehimisht p.sh në ligjet e posaçme të përdoruara nga ana e gjykatës në lidhje me ligjin e zbatueshëm.

Gjyqtarja përdor fjali me gjatësi mesatare, duke shprehur mendimin në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, duke organizuar fjalitë në rrjedhë logjike me njëra-tjetrën, si dhe paragrafët e vendimit me njëri-tjetrin. Mënyra e organizimit dhe shprehjes së mendimit në arsyetimin e vendimeve, përdorimi i thjeshtë dhe i drejtpërdrejtë i gjuhës, përzgjedhja e fjalëve, organizimi i tyre në fjali dhe më pas në paragrafë të lidhur me njëri tjetrin sipas linjës së arsytimit të vendimeve, reflektojnë qartësi dhe thjeshtësi në arsyetimin e vendimeve gjyqësore, duke i bërë ato të kuptueshme dhe duke mos lënë hapësirë për kuptim të gabuar apo të ndryshëm të mendimit të shprehur.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të mira në drejtim të treguesit të qartësisë, koncizitetit dhe kuptueshmërisë së vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Qartësia, konciziteti dhe kuptueshmëria e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

1.B.B. STRUKTURA E QËNDRUESHME DHE E MIRËORGANIZUAR E VENDIMIT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Struktura e vendimeve përfundimtare përgjithësisht është e standardizuar dhe respekton kërkesat e legjislacionit procedural. Struktura është e qëndrueshme dhe e mirëorganizuar, duke i shërbyer funksionit të qartësisë së argumentimit ligjor”.

Referuar burimeve të vlerësimit, evidentohet se gjyqtarja ndjek një strukturë të qëndrueshme dhe të organizuar në hartimin e vendimit, ku gjyqtarja i referohet prezantimit të fakteve, identifikimit të ligjit të zbatueshëm dhe lidhjes së tyre me konkluzionet e arritura. Gjyqtarja ka një metodologji të qartë të strukturimit të pjesëve përbërëse të vendimit, duke iu përshtatur edhe gjykimit në apel, për shkak të të cilit i duhet të citojë edhe vendimmarrjen objekt ankimi, si dhe shkaqet e ankimit të palëve. Vendimet gjyqësore burim vlerësimi përmbajnë pjesën hyrëse, pjesën përshkuese-arsyetuese, si dhe dispozitivin e vendimit.

Në pjesën hyrëse gjejnë pasqyrim të dhënave të regjistrimit, trupi gjykues dhe sekretarja gjyqësore, data dhe ora e shqyrtimit, palët, objekti i shqyrtimit, disponimi i Gjykatës së Shkallës së Parë, si dhe kërkimet/shkaqet e ankimit të subjekteve në gjykimin në apel.

Pjesa përshkuese–arsyetuese është e ndarë në disa nën-pjesë, edhe pse vizualisht jo me tituj të përcaktuar si p.sh. “rrethanat e faktit”, “ligji i zbatueshëm”, “analiza juridike”, nga mënyra e pasqyrimin të tyre në vendim konstatohet lehtë dhe dukshëm kjo nën-ndarje. Në pjesën përshkuese analizohen në mënyrë të detajuar: rrethanat e fakteve të çështjes siç rezultojnë nga

provat objekt shqyrtimi, rrethanat procedurale në gjykimin në apel dhe vlerësimi i gjykatës së apelit mbi shkaqet e ankimit, në të cilën gjyqtarja merr në analizë ligjin e zbatueshëm, si dhe elementët e tij në përputhje me faktet konkrete, për të përfunduar me një përmbledhje të gjyqtarës dhe konkluzionin e saj.

Në pjesën e dispozitivit gjen pasqyrim disponimi i gjykatës konform nenit 50 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në dhomë këshillimi, konform nenit 53 të ligjit nr.49/2012, për çështjet e shqyrtuara në seancë gjyqësore, dhe konform neneve 10/2, b dhe 40/3 të ligjit 49/2012, lidhur me çështjet e shqyrtuar në bazë të juridiksionit fillestar që ajo ka. Gjithashtu, gjen pasqyrim disponimi lidhur me të drejtën e ushtrimit të rekursit, afati i ushtrimit të kësaj të drejte, si dhe data e shpalljes së vendimit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të larta në ndjekjen e një strukture të qëndrueshme dhe të mirëorganizuar të vendimit.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Struktura e qëndrueshme dhe e mirë organizuar e vendimit” vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 10 pikë.

1.B.C. CILËSIA E ANALIZËS DHE ARGUMENTIT LOGJIK

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se: *“Në vendimin përfundimtar gjyqtarja {...}, jo vetëm merr në analizë në tërësinë e tij vendimin e dhënë nga shkalla e parë e gjykimit, por jep përgjigje të argumentuar për të gjitha shkaqet e parashtruara në ankim nga palët ankuese. Përmbajtja e vendimit përfundimtar është gjithëpërfshirëse dhe i jepet përgjigje pretendimeve të palëve. Në tekstet e vendimit ekziston lidhja midis fakteve të mosmarrëveshjes dhe konkluzioneve që ka arritur gjyqtarja. Në nxjerrjen e konkluzioneve i kushtohet rendësi analizës së normës ligjore në raport me faktet e konstatuara. Niveli i arsyesimit të vendimeve ligjore të vëzhguara respekton standardin e procesit të rregullt ligjor. Deri në momentin e hartimit të këtij raporti, nuk është identifikuar asnjë rast nga 3 dokumentet ligjore dhe 5 dosjet e vëzhguara, që të jetë cenuar nga Gjykata e Lartë për shkak të procesit të parregullt ligjor në aspektin e arsyesimit të vendimit gjyqësor”.*

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit për këtë tregues rezulton se:

Referuar vendimeve gjyqësore objekt vlerësimi, evidentohet se në tërësi, në të gjitha aktet e analizuara rezulton një nivel shumë i mirë arsyetimi, gjithnjë i plotë dhe i qartë, duke shqyrtuar dhe argumentuar çdo element të diskutueshëm në raport me faktin, si dhe çdo element të vlerësuar të nevojshëm për t'u analizuar në raport me aspektet procedurale. Arsyetimi i vendimeve përfundimtare ndjek një zhvillim logjik të koncepteve ligjore të parashikuara në ligjin procedural dhe material.

Evidentohet kujdesi i gjyqtarës në arsyetim, për të identifikuar dhe analizuar konceptet ligjore, në dobi të konkluzioneve të arritura lidhur me zgjidhjen e çështjes. Gjyqtarja në çdo rast ka evidentuar në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme thelbin e konfliktit objekt gjykimi, duke orientuar edhe analizën e koncepteve ligjore, në shërbim të arritjes së konkluzioneve në lidhje me zgjidhjen e çështjes. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse.

Evidentohet fakti që në arsyetimin e vendimeve, në analizën e përdorur në arritjen e konkluzionit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes civile, gjyqtarja i kushton një rëndësi të veçantë marrëdhënies shkak-pasojë në marrëdhëniet juridike civile.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka aftësi shumë të lartë në treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentit logjik”. Arsyetimi i vendimeve është i qartë, i plotë dhe përgjithësisht merr në analizë dhe u jep përgjigje të gjitha pretendimeve dhe kërtimeve të palëve ndërgjyqëse që lidhen në mënyrë konkrete edhe me shkaqet e ankimit të palëve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për treguesin “Cilësia e analizës dhe argumentimi logjik”, vlerësohet “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 25 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive profesionale të gjyqtarës”

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË PROFESIONALE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

2. AFTËSIA ORGANIZATIVE E GJYQTARES

Për të vlerësuar dhe pikëzuar aftësinë e gjyqtarës {...} në drejtim të aftësive organizative, vlerësuesi përqendrohet në aftësinë për të organizuar, menaxhuar dhe kontrolluar efektivisht procedurat gjyqësore. Produktiviteti është rrjedhojë e menaxhimit të kohës, i cili tregon sa mirë gjyqtarja përdor kohën e tij, si kur gjykon i vetëm, ashtu edhe në panel me të tjerë.

2.A. AFTËSIA PËR TË PËRBALLUAR NGARKESËN NË PUNË

2.A.A. RESPEKTIMI I AFATEVE LIGJORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Tre nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 48 pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet: “Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi”.*

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit, lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të zgjedhura nga gjyqtarja.

Në nenin 48 pika 2, të Ligjit nr. 49/2012, përcaktohet se Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjet brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi, që do të thotë nga data e regjistrimit të çështjes në gjykatë.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve rezulton se në 12

(dymbëdhjetë)¹⁹ prej tyre parashikohet afat ligjor brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes. Konkretisht:

- Vendimi 2 - (është regjistruar në gjykatë datën 26.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 26.05.2014) Gjykimi ka zgjatur 89 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Vendimi 3 - (është regjistruar në gjykatë datën 15.10.2015 dhe ka përfunduar në datën 16.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 32 ditë, duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 2 ditë, tejkallim ky i papërfillshëm, në këto kushte çështja do të konsiderohet se është shqyrtuar brenda afatit ligjor, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 1 - (është regjistruar në gjykatë datën 29.01.2014 dhe ka përfunduar në datën 26.02.2014) Gjykimi ka zgjatur 28 ditë, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 2 - (është regjistruar në gjykatë datën 17.02.2014 dhe ka përfunduar në datën 19.03.2014) Gjykimi ka zgjatur 30 ditë, brenda afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 3 - (është regjistruar në gjykatë datën 22.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 20.04.2015) Gjykimi ka zgjatur 333 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 4 - (është regjistruar në gjykatë datën 11.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.05.2015) Gjykimi ka zgjatur 341 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 5 - (është regjistruar në gjykatë datën 15.10.2014 dhe ka përfunduar në datën 16.11.2015) Gjykimi ka zgjatur 397 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 6 - (është regjistruar në gjykatë datën 10.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 07.05.2014) Gjykimi ka zgjatur 58 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 7 - (është regjistruar në gjykatë datën 21.03.2014 dhe ka përfunduar në datën 21.05.2014) Gjykimi ka zgjatur 61 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 8 - (është regjistruar në gjykatë datën 23.06.2014 dhe ka përfunduar në datën 28.09.2014) Gjykimi ka zgjatur 97 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 9 - (është regjistruar në gjykatë datën 28.05.2014 dhe ka përfunduar në datën 18.05.2015) Gjykimi ka zgjatur 355 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012;
- Dosja 11 - (është regjistruar në gjykatë datën 24.07.2014 dhe ka përfunduar në datën 25.03.2016) Gjykimi ka zgjatur 609 ditë, jashtë afatit ligjor prej 30 ditësh, të parashikuar në nenin 48/2 të ligjit 49/2012.

¹⁹ Nuk do të konsiderohen si çështje me afat ligjor, vendimin nr.1, shqyrtuar nga kjo gjykatë, në bazë të kompetencës funksionale të saj, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë, si dhe dosja nr.10 e cila është shqyrtuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve.

Për 12 (dymbëdhjetë) çështjet për të cilat ligji parashikon afat ligjor shqyrtimi, sikundër referohet më sipër, 9 (nëntë) prej tyre kanë përfunduar në tejkalim të afatit ligjor, pra gjyqtarja rezulton të ketë gjykuar **75% të çështjeve jashtë afatit ligjor**.

Në metodologjinë e pikëzimit, lidhur me këtë tregues, është përcaktuar hapësira e vlerësuesit për të përcaktuar një shkallë më të lartë pikëzimi, deri në një pikëzim maksimal, bazuar në analizën e të dhënave që rezultojnë nga analiza e të gjithave burimeve të vlerësimit, nisur nga tregues të tillë si: kompleksiteti i çështjeve, ngarkesa e gjyqtarit, rritja e volumit të punës, apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës së tij, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në rastin konkret, *në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara*, rezulton se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 1153 çështje, nga të cilat 607 çështje administrative dhe 546 marrëdhënie pune, mesatarisht rreth 384 çështje në vit, pa përfshirë këtu ngarkesën si anëtare e trupit gjykues. *Në lidhje me aspektin e rritjes së papritur të volumit të punës*, rezulton se gjatë vitit 2014 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është rritur ndjeshëm si pasojë e vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtarja është caktuar 1678 çështje, mesatarisht rreth 140 çështje në muaj. Po kështu, *në lidhje me aspektin e kushteve të punës*, rezulton se për periudhën 04.11.2013-09.06.2015 në Gjykatën Administrative të Apelit nuk ishin pjesë e organikës së saj ndihmësit ligjorë, sikurse parashikohet në nenin 6 të ligjit 49/2012,²⁰ çka do të ndikonte ndjeshëm në lehtësimin e ngarkesës së punës në këtë gjykatë, duke ju referuar këtu edhe detyrave të parashikuara në këtë nenin lidhur me ndihmësit ligjor.

KONKLUZIONE

Në tërësi, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me: (i) raportin e çështjeve të gjykuara në tejkalim të afatit ligjor, që rezultojnë në masën 75% (ii) ngarkesën e gjyqtarja si relatores (*në total ka gjykuar 1153 çështje ose 384 çështje në vit*)²¹ (iii) rritja e papritur të volumit të punës (*për vitin 2014 janë caktuar 1678 çështje*) dhe (iv) aspektet që lidhen me kushtet e punës, gjyqtarja për këtë tregues vlerësohet në nivelin maksimal të tij, duke e pikëzuar me 15 pikë

Shkalla e aftësisë së gjyqtarja dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrahet më sipër, në lidhje me treguesin “Respektimi i afateve ligjore”, gjyqtarja vlerësohet “0-10%”, duke e pikëzuar me 15 pikë.

²⁰ Para ndryshimeve të ligjit nr.39/2017.

²¹ Për gjyqtarin e Gjykatës Administrative të Apelit, në vendimin nr.261/2 të KLD nuk është përcaktuar standardi sasior i punës, që nënkupton ngarkesën minimale të punës që duhet të realizohet nga gjyqtari brenda një viti. Në rrethana të tilla, nëse do t'i referohemi standardit minimal të punës të përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit, dhoma civile, ngarkesa e gjyqtarja rezulton **92%** më shumë se standardit minimal i punës (*384 çështje në vit, nga 200 të përcaktuara për gjyqtarin e gjykatës së apelit, dhoma civile*).

2.A.B. PLOTËSIMI I STANDARDEVE MINIMALE KOHORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për të gjitha çështjet. Për pasojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja.

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se *“Standardet matëse për sasinë të Sistemit të Vlerësimit të Gjyqtarëve nuk zbatohen drejtpërdrejt për gjyqtarët e gjykatave administrative, pasi janë miratuar nga ish-KLD përpara fillimit të funksionimit të këtyre gjykatave. Konkretisht, ky Sistem Vlerësimi nuk njuh seksion administrativ në gjykatat e apelit. Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultoi se kohëzgjatja e gjykimeve në referim të datës së regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit nga gjyqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 28 ditë deri në 13 muaj e 1 ditë. Kohëzgjatja e gjykimeve respektivisht (referuar datës së regjistrimit në gjykatën e apelit) sipas dosjeve të vëzhguara rezultojnë 28 ditë (shih dosjen 1); 30 ditë (shih dosjen 2); 11 muaj e 26 dite (shih dosjen 3); 11 muaj e 7 ditë (shih dosjen 4) dhe 13 muaj e 1 ditë (shih dosjen 5)”*.

Nga vëzhgimi i 11 (njëmbëdhjetë) çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 (tre) vendimeve të përzgjedhura nga gjyqtarja, referuar kategorisë së çështjeve rezultojnë se vetëm për 2 (dy) prej tyre nuk parashikohet afat ligjor, brenda të cilit duhet të përfundojë gjykimi i çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit. Konkretisht, çështja që i përket vendimit nr. 4, datë 27.01.2016, është shqyrtuar nga kjo gjykatë, në bazë të kompetencës funksionale të saj, duke e gjykuar si gjykatë e shkallës së parë, si dhe çështja që i përket vendimit nr. 2595, datë 15.09.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, të shqyrtuar në seancë gjyqësore në prani të palëve.

Në ligjin nr. 49/2012 nuk parashikohet afat ligjor për gjykimin e çështjeve administrative të themelit në gjykatën e shkallës së parë. Lidhur me kohëzgjatjen e gjykimit në çështjet administrative, pavarësisht se ligji nr.49/2012 nuk parashikon afat gjykimi për kategori të caktuara çështjesh, përveç kërkesave të veçanta sipas objektit të tyre, ai parashikon afate për

kryerjen e veprimeve procedurale prej momentit të shortimit të çështjes deri në përfundim të gjykimit.

Ndërkohë, në vendimin nr. 261/2, datë 14.4.2010, të KLD, nuk rezulton të jetë përcaktuar standardi minimal kohor për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative në gjykatën e apelit, por rezulton që për gjykatat e apeli të jetë përcaktuar standardi minimal kohor vetëm për gjykimet civile, duke u përcaktuar ky afat, jo më tej se 6 muaj.

Referuar Udhëzuesit “Për plotësimin e tabelave me të dhënat statistikore për efekt të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, miratuar me vendimin nr. 60, datë 30.01.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “, për gjykatën administrative të apelit, për çështjet për të cilat nuk ka afat ligjor gjykimi, “*afati i përfundimit të gjykimit*” do të konsiderohet periudha kohore nga data e nxjerrjes së çështjes për gjykim nga gjyqtari relator subjekt vlerësimi deri në datën e shpalljes së vendimit.

Referuar këtij përcaktimi për 2 (dy) çështjet për të cilat zbatohet standardi minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit, do të rezultonte se:

- (i) Çështja që i përket vendimin nr.4, datë 27.01.2016, është regjistruar në gjykatë në datën 24.04.2015, duke përfunduar gjykimin për 9 muaj e 3 ditë, ***tej afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit.***
- (ii) Çështja me nr.6821/229/327 regjistri, me objekt “Anulim/shfuqizim njoftim vlerësimi”, rezulton se është regjistruar në gjykatë në datën 05.09.2014 dhe me shortin elektronik të datës 31.03.2016 i është caktuar gjyqtarës {...}, në cilësinë e relatores. Nga aktet e dosjes (urdhri për njoftimin e palëve ndërgjyqëse) rezulton se ajo është vënë në lëvizje nga gjyqtarja në datën 06.04.2016 dhe ka përfunduar në datën 15.09.2016. Pra referuar të dhënave të sipërcituara rezulton se çështja ka përfunduar për 5 muaj e 9 ditë nga data e nxjerrjes për gjykim, ***brenda afatit 6 muaj të standardit minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit.***

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, pikëzimi për këtë tregues përcaktohet duke iu referuar raportit të çështjeve për të cilat vendimi është marrë në tejkallim të standardit minimal kohor, me numrin total të çështjeve të gjykuara, për të cilat ligji nuk parashikon afat ligjor gjykimi. Duke iu referuar këtij përcaktimi, nëse për çështjen e gjykuar për të cilën zbatohet standardi minimal kohor, do të zbatohet standardit minimal kohor për gjykimet civile në gjykatën e apelit, raporti i çështjeve të gjykuara tej standardit me totalin e çështjeve për të cilit zbatohet standardi minimal kohor, do të rezultonte 50%. Por vlerësuesi veç analizës matematikore duhet të kryejë edhe një analizë logjike të të dhënave, duke shmangur çështje që nuk janë përgjegjësi e gjyqtarit. Në këtë kontekst u analizua kompleksiteti i çështjes, volumi i çështjeve, të përcaktuara në Metodologji si komponentët që mund të çojë në një pikëzim më të lartë se ai që rezulton nga analiza matematikore, nga e cila rezultoi se:

Çështja që i përket vendimit nr.4, datë 27.01.2016 i Gjykatës Administrative të Apelit, me objekt “*Shfuqizim (anulim) vendimi të Këshillit të Bashkisë Sarandë për miratimin e paketës fiskale...*”. Referuar të dhënave të vendimit rezulton se çështja mban si datë regjistrimi 24.04.2015 dhe datë përfundimi 27.01.2016, duke përfunduar brenda një afati prej 9 muajsh e 8 ditë, pra jashtë standardit minimal kohor prej 6 muaj të parashikuar në vendimin nr.261/2 të KLD. Afati tejkallimit të çështjes nga standardi minimal kohor është rreth 3 muaj, por këtu duhet të mbahet

në vëmendje edhe fakti se muaji Gusht (30 ditë) përkon edhe me pushimet vjetore të gjyqtarëve, e në këtë kontekst nuk duhet të përlloritet në afatin e përfundimit të çështjes duke rezultuar vetëm rreth 2 muaj tej standardit. Në dosje nuk ka të dhëna në lidhje me shkaqet e shtyrjeve të seancave gjyqësore apo me mënyrën e planifikimit dhe menaxhimit të çështjes, pasi ky vendim është vendim i përzgjedhur nga ana e gjyqtarës. Po kështu në arsyetimin e vendimit nuk ka të dhëna lidhur me ecurinë procedurale të çështjes, në mënyrë që shkalla e kompleksitetit të mbahet parasysht nga vlerësuesi në përcaktimin e shkallës së aftësisë e pikëzimit e gjyqtarës.

Nga ana tjetër, në aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, evidentohet se gjyqtarja ka përfunduar në total për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit 1153 çështje, nga të cilat 607 çështje administrative dhe 546 marrëdhënie pune, mesatarisht 384 çështje në vit ose 92% më shumë se standardit minimal i punës.

KONKLUZIONE

Për sa më sipër, për pikëzimin e këtij treguesi, duke iu referuar analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit lidhur me:

- (i) raportin e çështjeve të gjykuara tej standardit me numrin total të çështjeve të analizuar si më sipër cituar, që rezulton në masën 50%;
- (ii) faktorët që kanë ndikuar në kohëzgjatjen e gjykimit të cilat, nuk rezultojnë të jenë për shkaqe që janë përgjegjësi e gjyqtarit;
- (iii) standardi sasior i punës i cili është dukshëm më e lartë se ngarkesa minimale e përcaktuar me Vendimin nr.261/2 të KLD, vlerësoj se gjyqtarja për këtë tregues duhet të vlerësohet në nivel maksimal të tij.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi:** Referuar sa më sipër, në lidhje me treguesin “Plotësimi i standardeve minimale kohore” gjyqtarja vlerësohet në nivelin “Mbi 0 - 10%”, duke u pikëzuar me 5 pikë.*

2.A.C. KOHA MESATARE QË I DEDIKOHET ÇDO ÇËSHTJEJE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, në procesin e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhura me short).

Në raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, pas analizës së burimeve, konkludohet se “Nga analiza e 5 dosjeve të përzgjedhura me short, rezultojnë se kohëzgjatja e gjykimeve në referim të datës së

regjistrimit të çështjes në Gjykatën Administrative të Apelit nga gjyqtarja {...} ka qenë në intervale kohore nga 28 ditë deri në 13 muaj e 1 ditë. Kohëzgjatja e gjykimeve respektivisht (referuar datës së regjistrimit në gjykatën e apelit) sipas dosjeve të vëzhguara rezultojnë 28 ditë (shih dosjen 1); 30 ditë (shih dosjen 2); 11 muaj e 26 ditë (shih dosjen 3); 11 muaj e 7 ditë (shih dosjen 4) dhe 13 muaj e 1 ditë (shih dosjen 5). Kohëzgjatja efektive e gjykimeve (në referim të datës së listës shpalljes nga kryetari i gjykatës me të cilën është caktuar seanca e parë gjyqësore) nga ana e gjyqtarës ka qenë në intervale kohore nga 28 ditë deri në 2 muaj e 23 ditë. Kjo kohëzgjatje efektive e gjykimeve respektivisht sipas dosjeve të vëzhguara rezultojnë 28 ditë (shih dosjen 1); 30 ditë (shih dosjen 2); 2 muaj e 23 ditë (shih dosjen 3); 19 ditë (shih dosjen 4) dhe 2 muaj e 19 ditë (shih dosjen 5). Tre nga pesë çështjet e vëzhguara janë gjykuar jashtë afatit ligjor të përcaktuar nga neni 48 pika 2 e ligjit nr. 49/2012, ku parashikohet: "Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi... Përsa i përket kohëzgjatjes së gjykimeve në tre dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti i rivlerësimit nuk ka të dhëna referuese për datën e regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit, për rrjedhojë nuk përlogaritet kohëzgjatja e atyre gjykimeve".

Në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës {...}, referuar formatit të statistikave të administruara për efekt të këtij procesi, të cilat shërbejnë si burim vlerësimi edhe në procedurën e gradimit, nuk ka të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për secilën nga kategoritë e çështjeve.

Për rrjedhojë, vlerësimi lidhur me këtë tregues do të bëhet duke iu referuar vetëm vendimit nr. 4, datë 27.01.2016, të përzgjedhur nga gjyqtarja dhe vendimit nr. 2595, datë 15.09.2016 për të cilin zbatohet standardi minimal kohor, jo afati ligjor i gjykimit.²²

Konkretisht, koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje, për kategorinë "Çështje administrative me palë kundërshtare" është 223 ditë, pra më e gjatë se standardi minimal për gjykimin e çështjeve civile në Gjykatën e Apelit.²³

KONKLUZIONE

Duke marrë në konsideratë faktin se në të dhënat e analizuara lidhur me kohën mesatare që i dedikohet çdo çështjeje është analizuar vetëm për dy prej çështjeve të gjykuara, duke mos pasur të dhëna specifike për kohëzgjatjen e gjykimit për çështjet të tjera të gjykuara po në bazë të kompetencës funksionale, apo të shqyrtuara në seancë gjyqësore, si dhe duke marrë në konsideratë, aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara për gjithë periudhën 3-vjeçare të vlerësimit (1153 çështje, nga të cilat 607 çështje administrative dhe 546 marrëdhënie pune, vlerësoj se ky tregues duhet të vlerësohet maksimalisht.

²² Në Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues, parashikohet se: "Në numrin total të çështjeve të gjykuara nuk përfshihen çështjet për të cilat parashikohen në ligj afate gjykimi".

²³ Në pikën 5 shkronja h të Aneksit I të vendimit të KLD nr. 261/2, parashikohet se: "Gjykimet civile në gjykatën e apelit, jo më tej se 6 muaj".

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Referuar sa më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare që i dedikohet çdo çështjeje” vlerësohet “Më e shkurtër ose e barabartë me standardin për të gjitha e kategoritë e çështjeve”, duke e pikëzuar me 5 pikë.

2.A.Ç. RENDIMENTI I PËRFUNDIMIT TË ÇËSHTJEVE GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Të dhënat statistikore;
- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar.

Referuar Raportit për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me rendimentin e përfundimit të çështjeve konkludohet se: “*Subjekti i rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 08.10.2013-08.10.2016, ka kryer detyrën e gjyqtarës së Gjykatës Administrative të Apelit. Ajo ka deklaruar se në periudhën 2014-2016, i janë caktuar për gjykim 3.475 çështje administrative dhe ka përfunduar po për këtë periudhë 1.268 çështje administrative. Rendimenti i përfundimit të çështjeve, bazuar në këto të dhëna është 36.5 %*”.

Referuar të dhënave statistikore të dërguara nga Gjykata Administrative e Apelit, me shkresën nr.532 Prot, datë 14.12.2018,²⁴ të administruara në dosjen e rivlerësimit, rezulton se gjyqtarja {...} për periudhën 04.11.2013–08.10.2016, paraqet këtë ngarkesë çështjesh, të ndarë për çdo vit kalendarik:

- Për vitin 2013 (04.11.2013²⁵-31.12.2013), gjyqtarja ka përfunduar 2 çështje.
- Për vitin 2014 (01.01.2014-31.12.2014), gjyqtarës i janë caktuar për shqyrtim 1678 çështje të reja dhe ka përfunduar gjykimin për 526 çështje administrative dhe marrëdhënie pune. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 31.34%.**
- Për vitin 2015 (01.01.2015-31.12.2015), gjyqtarës i janë caktuar për shqyrtim 1268 çështje të reja dhe ka përfunduar gjykimin për 347 çështje administrative dhe marrëdhënie pune. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 27.36%.**
- Për vitin 2016 (01.01.2016-08.10.2016), gjyqtarës i janë caktuar për shqyrtim 529 çështje të reja dhe ka përfunduar gjykimin për 278 çështje administrative dhe marrëdhënie pune. **Rendimenti për këtë vit kalendarik ka qenë 52.55%.**

Pra, për të gjithë periudhën e vlerësimit rezulton se gjyqtarës i janë caktuar në total 3475 çështje dhe ka përfunduar me vendim deri në tetor 2016, 1153 çështje. Sa i përket rendimentit sipas këtyre të dhënave, **rezulton një normë likuidimi çështjesh prej 33.17%.**

²⁴ Në faqen 46-91 të dosjes të rivlerësimit kalimtar.

²⁵ Data e fillimit të funksionimit të gjykatave administrative.

KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, për të vlerësuar këtë tregues, vlerësuesi nuk bën vetëm një veprim matematikor për të përcaktuar rendimentin e përfundimit të çështjeve, por ai bazohet edhe në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve apo aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai nivelit të përqindjes. Ky vlerësim mund të shkojë deri në pikëzimin maksimal, nëse gjyqtari ka gjykuar brenda vitit kalendarik më shumë se 50% të standardit minimal të ngarkesës në fuqi. Në rastin konkret, rezulton se gjatë vitit 2014 volumi i punës në Gjykatën Administrative të Apelit është rritur ndjeshëm si pasojë e vendimit unifikues nr. 3, datë 06.12.2013, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ku rezulton se gjatë vitit 2014 gjyqtarës i janë caktuar 1678 çështje, mesatarisht rreth 140 çështje në muaj, fakt ky që ndikon në llogaritjen matematikore të normës së likuidimit të çështjes. Në lidhje me aspektin sasior të volumit të çështjeve të përfunduara, rezulton se gjyqtarja për periudhën e vlerësimit ka përfunduar dukshëm më shumë se standardi minimal i ngarkesës i përcaktuar për gjyqtarin e gjykatës së apelit dhoma civile (92% më shumë, 384 çështje në vit, nga 200 të përcaktuara për gjyqtarin e gjykatës së apelit, dhoma civile). Po kështu, në lidhje me kushtet e punës, rezulton se mungesa e ndihmësve ligjorë, si strukturë mbështetëse e gjykatës është një tjetër shkak që ndikon në volumin e çështjeve të përfunduara, duke iu referuar detyrave që ka parashikuar neni 6 i ligjit 49/2012, për ta. Në këto kushte, për këtë tregues gjyqtarja vlerësohet në nivelin maksimal të tij.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin "Rendimenti i përfundimit të çështjeve gjyqësore" është "+99%", duke e pikëzuar me 10 pikë.

2.A.D. KOHA MESATARE E ARSYETIMIT TË VENDIMIT PËRFUNDIMTAR GJYQËSOR

Në lidhje me këtë tregues, në Metodologjinë e Pikëzimit parashikohet se ky është treguesi mesatar i kohës së arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore të dhëna nga gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit, që llogaritet nga data e dhënies së vendimit, deri në datën e depozitimit në kryesekretari të vendimit të arsyetuar. Në vlerësimin për periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar të dhënave që ofrojnë tabelat me të dhëna statistikore të administruara në procesin e rivlerësimit, nuk jepen të dhëna për kohën e arsyetimit të të gjitha vendimeve gjyqësore, sipas kategorive. Për këtë arsye, ky tregues do të vlerësohet dhe pikëzohet duke iu referuar të dhënave për 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim.

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short);

- Informacioni i përcjellë nga gjykata lidhur me afatin e dorëzimit të vendimit të arsyetuar.

Referuar raportit për analizimin e aftësive profesionale, të hartuar në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimit përfundimtar gjyqësor, konkludohet se *“Lidhur me kohën mesatare të arsyetimit të vendimeve gjyqësore, si datë e arsyetimit të vendimit është vlerësuar data e dorëzimit të dosjes gjyqësore në sekretari, si e vetmja e dhënë objektive. Nga vëzhgimi i 5 dosjeve të shortuara është konstatuar se gjyqtarja {...} jo në çdo rast i ka kushtuar rendësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore. Konkretisht, arsyetimi i vendimeve është kryer pas 7 ditëve nga shpallja (shih dosjen 1), pas 1 muaj e 18 ditëve nga shpallja (shih dosjen 2), pas 8 ditëve nga shpallja (shih dosjen 3), pas 1 muaj e 7 ditëve nga shpallja (shih dosjen 4) dhe pas 28 ditëve nga shpallja (shih dosjen 5). Gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit "08 tetor 2013-08 tetor 2016", për gjyqtaren {...} janë verifikuar dy ankesa mbi bazë informacioni periodik të ardhur nga kryetari i gjykatës për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara dhe i janë regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik. Po ashtu është verifikuar edhe një ankese për moszbardhjen e vendimit dhe i është regjistruar gjyqtares për efekt vlerësimi profesional dhe etik (shih Të Dhënat nga Burimet Arkivore të KLGJ-së). Se fundmi, duke konsideruar të dhënat e mësipërme, duhet evidentuar se gjyqtarja {...} ka patur ngarkesë të lartë sasiore. Pavarësisht se për përfundimin e gjykimit të çështjeve brenda afatit ligjor (1 muaj) nuk varej gjithçka nga ajo, pasi planifikimi i seancës së parë gjyqësore bëhej nga kryetari i gjykatës, me urdhër të të cilit sekretaria gjyqësore bën shpalljen e listës së gjykimeve, ajo nuk ka bërë përpjekjet e duhura për arsyetimin e vendimeve në respektim të afatit ligjor (7 ditë) të parashikuar nga neni 55/3 i ligjit nr. 49/2012”.*

Në nenin 55, pika 3 të Ligjit 49/2012, parashikuar se *“Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore”.*

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se :

- Dosja 1, që i përket vendimit me nr. 397, datë 29.01.2014, është dorëzuar në datën 05.03.2014 - (7 ditë), brenda afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 2, që i përket vendimit me nr. 914, datë 19.03.2014 është dorëzuar në datën 07.05.2014 - (49 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 3, që i përket vendimit me nr. 814, datë 20.04.2015 është dorëzuar në datën 28.04.2015- (8 ditë), duke e tejkaluar afatin ligjor vetëm me 1 ditë, tejkalim ky i papërfillshëm;
- Dosja 4, që i përket vendimit me nr. 1039, datë 18.05.2015 është dorëzuar në datën 24.06.2015- (37 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 5, që i përket vendimit me nr. 2420, datë 16.11.2015 është dorëzuar në datën 14.12.2015- (28 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012.

Sipas informacionit të dërguar nga Gjykata Administrative e Apelit, lidhur me 6 (gjashtë) nga dosjet e përzgjedhura me shortin e datës 18.05.2021, rezulton se:

- Dosja 6, që i përket vendimit me nr. 1525, datë 07.05.2014 është dorëzuar në datën 26.06.2014- (50 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 7, që i përket vendimit me nr. 1989, datë 21.05.2014 është dorëzuar në datën 02.09.2014- (104 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 8, që i përket vendimit me nr. 2007, datë 28.09.2015 është dorëzuar në datën 26.10.2015- (28 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 9, që i përket vendimit me nr. 1025, datë 18.05.2015 është dorëzuar në datën 23.07.2015- (66 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 10, që i përket vendimit me nr. 2595, datë 15.09.2016 është dorëzuar në datën 26.09.2016- (11 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012;
- Dosja 11, që i përket vendimit me nr. 663, datë 25.03.2016 është dorëzuar në datën 18.04.2016- (24 ditë), jashtë afatit 7 ditor, të përcaktuar në nenin 55 të ligjit 49/2012.

Në relacionin e datës 19.11.2014, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimeve nga gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se për 76 vendime,²⁶ nuk është respektuar afati ligjor prej 7 ditësh, për dorëzimin e dosjes gjyqësore pas dhënies së vendimit përfundimtar.

²⁶ Konkretisht vendimi nr. 1188, datë 02.04.2014 (është dorëzuar pas 58 ditësh); vendimi nr. 1189, datë 02.04.2014 (është dorëzuar pas 53 ditësh); vendimi nr. 1190, datë 03.04.2014 (është dorëzuar pas 34 ditësh); vendimi nr. 1194, datë 03.04.2014 (është dorëzuar pas 50 ditësh); vendimi nr. 1195, datë 03.04.2014 (është dorëzuar pas 40 ditësh); vendimi nr. 1199, datë 03.04.2014 (është dorëzuar pas 40 ditësh); vendimi nr. 1200, datë 03.04.2014 (është dorëzuar pas 33 ditësh); vendimi nr. 1206, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 46 ditësh); vendimi nr. 1207, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 46 ditësh); vendimi nr. 1210, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 46 ditësh); vendimi nr. 1212, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 46 ditësh); vendimi nr. 1213, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 46 ditësh); vendimi nr. 1225, datë 07.04.2014 (është dorëzuar pas 36 ditësh); vendimi nr. 1500, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 39 ditësh); vendimi nr. 1501, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1502, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1503, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1504, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1506, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1507, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1508, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1509, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1510, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1511, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1512, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1513, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1516, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1519, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1520, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1521, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1523, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1526, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1527, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1570, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 43 ditësh); vendimi nr. 1572, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1573, datë 07.05.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 1670, datë 12.05.2014 (është dorëzuar pas 37 ditësh); vendimi nr. 1809, datë 14.05.2014 (është dorëzuar pas 35 ditësh); vendimi nr. 1814, datë 14.05.2014 (është dorëzuar pas 36 ditësh); vendimi nr. 1815, datë 14.05.2014 (është dorëzuar pas 36 ditësh); vendimi nr. 1816, datë 14.05.2014 (është dorëzuar pas 36 ditësh). Po kështu, rezultojnë të pa dorëzuara deri në datën 27.06.2014: vendimi nr. 1191, datë 03.04.2014 (85 ditë); vendimi nr. 1193, datë 03.04.2014 (85 ditë); vendimi nr. 1196, datë 03.04.2014 (85 ditë); vendimi nr. 1197, datë 03.04.2014 (85 ditë); vendimi nr. 1201, datë 03.04.2014 (85 ditë); vendimi nr. 1505, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1514, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1515, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1517, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1518, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1522, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1524, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1525, datë 07.05.2014 (51 ditë); vendimi nr. 1807, datë 14.05.2014 (44 ditë); vendimi nr. 1811, datë 14.05.2014 (44 ditë); vendimi nr. 1812, datë 14.05.2014 (44 ditë); vendimi nr. 1813, datë 14.05.2014 (44 ditë); vendimi nr. 1817, datë 14.05.2014 (44 ditë); vendimi nr.

Në relacionin e datës 19.02.2015, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e vendimit nr. 4046, datë 04.11.2014, nga Gjyqtarja {...}, ku ka rezultuar se dosja që i përket vendimit nr.4046, datë 04.11.2014, është dorëzuar në sekretarinë e gjykatës në datën 12.12.2014, pra pas 38 (tridhjetë e tetë) ditësh nga shpallja.

Po kështu, në relacionin e datës 24.07.2015, të Inspektoratit të KLD, objekt verifikimi dhe analize ka qenë respektimi i afatit ligjor, lidhur me dorëzimin e 6 vendimeve²⁷ të dorëzuara nga gjyqtarja jashtë afatit ligjor prej 7 ditësh.

Lidhur me shkaqet e mosarsyetimit të vendimeve brenda afatit ligjor, referuar relacioneve, rezulton se gjyqtarja ka parashtruar si shkak për dorëzimin me vonesë të vendimeve të arsyetuara, ngarkesën e punës, jo vetëm për shqyrtimin e çështjeve të caktuara me short, por edhe të atyre çështjeve në të cilat gjyqtarja ka qenë në cilësinë e anëtares së trupit gjykues. Po kështu, vonesa në dorëzimin e dosjeve ka ardhur jo vetëm për shkak të ngarkesës së dosjeve në gjykim, por edhe për shkak të mungesës së infrastrukturës, në drejtim të mungesës së sekretares gjyqësore, ku tre gjyqtarë kanë pasur një sekretare gjyqësore, në drejtim të mungesës së printerit, letrës, bojë printeri, kompjuterit etj. Një tjetër shkak i parashtruar nga gjyqtarja ka qenë edhe mungesa e ndihmësit ligjor.

Referuar të dhënave burim vlerësimi, evidentohet se koha mesatare e arsyetimit të vendimeve gjyqësore për kategori të veçanta çështjesh, krahasuar me afatin ligjor 7 ditor të parashikuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është si më poshtë:

- Në çështjet e kategorisë “Administrative me palë kundërshtarë”, koha mesatare e arsyetimit është 42 ditë;
- Në çështjet e kategorisë “Marrëdhënie pune”, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është 55 ditë.

Pra, koha mesatare e arsyetimit të vendimit është më e gjatë se afati 7 ditor i përcaktuar në nenin 55, të Ligjit nr.49/2012, për të gjitha kategoritë e çështjeve, duke përkthyer me një vlerësim prej 3 pikësh. Afati 7 ditor i arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar i përcaktuar në nenin 55 të ligjit nr. 49/2012, është shumë më i shkurtër krahasuar me afatin 20 ditor të arsyetimit të vendimeve gjyqësore civile sipas parashikimeve të nenit 308 pg 2 i Kodit të Procedurës Civile (pas ndryshimeve me ligjin nr.38/2017, datë 30.03.2017). Edhe pse ligji nr.49/2012 përbën ligj të posaçëm dhe sipas nenit 1 pika 2 të tij, dispozitat e K.Pr.Civile zbatohen vetëm në rastet kur nuk parashikohet ndryshe në të, përsëri duket se pas ndryshimeve

1989, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1990, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1991, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1992, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1993, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1994, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1995, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1996, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1997, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1998, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 1999, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 2000, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 2001, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 2002, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 2056, datë 21.05.2014 (37 ditë); vendimi nr. 2057, datë 26.05.2014 (31 ditë) dhe vendimi nr. 2058, datë 26.05.2014 (31 ditë).

²⁷ Konkretisht vendimi nr. 3952, datë 28.10.2014 (është dorëzuar pas 49 ditësh); vendimi nr. 3925, datë 27.10.2014 (është dorëzuar pas 44 ditësh); vendimi nr. 3986, datë 29.10.2014 (është dorëzuar pas 42 ditësh); vendimi nr. 4046, datë 04.11.2014 (është dorëzuar pas 38 ditësh); vendimi nr. 4050, datë 04.11.2014 (është dorëzuar pas 38 ditësh) dhe vendimi nr. 4125, datë 10.11.2014 (është dorëzuar pas 32 ditësh);

të K.Pr.Civile dhe shkaqeve që kanë çuar ligjvënësin në përcaktimin e afatit 20 ditor të arsyetimit të vendimit gjyqësor, ka një mungesë harmonizimi mes qëllimit të parashikimit të këtij afati me afatin e arsyetimit të parashikuar në ligjin nr.49/2012.

KONKLUZIONE

Sipas Metodologjisë, për të pikëzuar këtë tregues, analiza e të dhënave burim vlerësimi bazohet në kompleksitetin e çështjeve, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës, të cilat mund të çojnë në një pikëzim më të lartë nga ai i tabelës së mësipërme, duke zbatuar një koeficient jo më shumë se 20%. Në rastin konkret, lidhur me këtë tregues duke pasur në konsideratë, volumin e çështjeve, rritjen e papritur të volumit të çështjeve, si dhe aspekte të tjera që lidhen me kushtet e punës (*mungesa e ndihmësit ligjor, mungesa e printerit, kompjuterit etj.*) propozohet që për këtë tregues gjyqtarja të vlerësohet në një nivel më të lartë pikëzimi, kjo duke pasur parasysh se vlerësuesi nuk mund të vlerësojë aftësinë e gjyqtarit në lidhje me këtë tregues tej rritjes së pikëzimit me vetëm 1 shkallë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Koha mesatare e arsyetimit të vendimit gjyqësor përfundimtar” konsiderohet “Më e gjatë se afati procedural për shumicën e kategorive të çështjeve”, duke e pikëzuar me 6 pikë.

2.B. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË KRYER PROCEDURAT GJYQËSORE

2.B.A. NUMRI MESATAR I SEANCAVE PËR ÇDO ÇËSHTJE DHE KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR SHMANGIEN E ATYRE JO-PRODUKTIVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Subjekti i rivlerësimit {...} ka aftësi për të kryer procedurat gjyqësore në funksion të zgjidhjes së çështjes. Në 3 prej 5 dosjeve të vëzhguara u konstatua se gjykimet kanë përfunduar me 1 seancë në dhomë këshillimi, të cilat kanë qenë produktive, në përfundim të të cilave është shpallur vendimi (shih dosjet nr. 1, 2 dhe 4). Në dy raste gjykimi ka përfunduar me dy seanca, ku seancat e para kanë qenë joproduktive, në një rast

për shkak të analizës vjetore të gjykatës dhe në një rast për mos shpalljen e listës së gjykimeve (shih dosjet 3 dhe 5)”.

Nga vëzhgimi i 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, të cilat i përkasin kategorive të çështjeve me palë kundërshtare (*çështje administrative me palë kundërshtare dhe marrëdhënie pune*), lidhur me numrin e seancave gjyqësore, rezultojnë si më poshtë:

Në çështjet e përzgjedhura me short, të administruara në dosjen e rivlerësimit:

- Dosja 1 – që i përket çështjes administrative, me nr. 367 regjistri, datë regjistrimi 29.01.2014, përfunduar me vendimin nr.397, datë 26.02.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 2 – që i përket çështjes administrative, me nr. 863 regjistri, datë regjistrimi 17.02.2014, përfunduar me vendimin nr.914, datë 19.03.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 3 – që i përket çështjes administrative, me nr. 4045/189 regjistri, datë regjistrimi 22.05.2014, përfunduar me vendimin nr.814, datë 20.04.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 4 – që i përket çështjes administrative, me nr. 4843/684 regjistri, datë regjistrimi 11.06.2014, përfunduar me vendimin nr.1039, datë 18.05.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 5 – që i përket çështjes administrative, me nr. 8202/3592 regjistri, datë regjistrimi 15.10.2014, përfunduar me vendimin nr.2420, datë 16.11.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.

Në çështjet e përzgjedhura me short, pas fillimit të procedurës së vlerësimit:

- Dosja 6 – që i përket çështjes administrative, me nr. 1546 regjistri, datë regjistrimi 10.03.2014, përfunduar me vendimin nr.1525, datë 07.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 7 – që i përket çështjes administrative, me nr. 1840 regjistri, datë regjistrimi 21.03.2014, përfunduar me vendimin nr.1989, datë 21.05.2014, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 8 – që i përket çështjes administrative, me nr. 5339/974 regjistri, datë regjistrimi 23.06.2014, përfunduar me vendimin nr.2007, datë 28.09.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 9 – që i përket çështjes administrative, me nr. 4317/366 regjistri, datë regjistrimi 18.05.2015, përfunduar me vendimin nr.1025, datë 18.05.2015, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.
- Dosja 10 – që i përket çështjes administrative, me nr. 6821/2291/327 regjistri, datë regjistrimi 05.09.2014, përfunduar me vendimin nr.2595, datë 15.09.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë që për përfundimin e çështjes të jenë zhvilluar 6 (gjashtë) seanca gjyqësore, nga të cilat vetëm 1 (një) seancë ka qenë joproduktive, për shkak të mosformimit të turpit gjyqësor, seancat e tjera janë shtyrë për shkaqe procedurale.
- Dosja 11 – që i përket çështjes administrative, me nr. 6602/2082/251 regjistri, datë regjistrimi 24.07.2014, përfunduar me vendimin nr.663, datë 25.03.2016, të Gjykatës Administrative të Apelit, rezultojnë të jetë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe nuk ka seanca gjyqësore të zhvilluara.

Nga tërësia e të dhënave si më sipër, rezultojnë se vetëm në 1 (një) nga 11 (njëmbëdhjetë) çështjet e vëzhguara, është shqyrtuar në seancë gjyqësore dhe numri i seancave gjyqësore të zhvilluara nga gjyqtarja është 6 (gjashtë).

Sa i përket kryerjes së veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, duke iu referuar akteve të dosjeve të përzgjedhura me short, rezulton se:

- Gjyqtarja ka mbikëqyrur si duhet procedurën e kryerjes së njoftimeve, duke verifikuar se njoftimet janë të plota dhe të qarta për palët që u drejtohen, si dhe njoftimin e të drejtës së palëve për të paraqitur deri në 5 ditë para seancës parashtrimet me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankimin;
- Shtyrjet e seancave gjyqësore kanë qenë për shkaqe të ndryshme. Konkretisht, evidentohet se vetëm një seancë nuk është zhvilluar për shkak të mosformimit të trupit gjykues, për mosparaqitjen e një prej anëtarëve të trupit gjykues. Në të gjitha rastet e tjera shtyrjet e seancave gjyqësore kanë ndodhur për shkaqe procedurale të tilla si: *dhënien kohë palës së paditur (ankuese) për të parashtruar shkaqet e ngritura në ankim dhe që janë të lidhura me situatën faktike, për të cilën kishte nevojë të ishte i pranishëm inspektori që kishte bërë kontrollin objekt gjykimi, lënien kohë palës së paditur për të bërë verifikimet e duhura, lidhur me pyetjet e bëra nga gjykata, lënien kohë palës paditëse për të paraqitur provat në formën e kërkuar nga ligji, dhënia kohë palëve për përgatitjen e diskutimit përfundimtar në referim të parashikimeve të nenit 302 të K.Pr.Civile, duke respektuar afatin ligjor për caktimin e seancës vijuese (afati 5 ditor për dhënien kohë palëve për diskutimin përfundimtar).*

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, për treguesin “Numri mesatar i seancave gjyqësore për çdo çështje dhe kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për shmangien e atyre joproductive”, duke iu referuar të dhënave që rezultojnë nga vëzhgimi i çështjeve të përzgjedhura me short, rezulton se numri i seancave gjyqësore është 6 seanca, por rezulton që gjyqtarja në çdo rast ka treguar kujdes, duke marrë të gjitha masat e nevojshme procedurale për shmangien e seancave joproductive, për planifikimin dhe zhvillimin e seancave me efektivitet.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, pavarësisht se numri i seancave gjyqësore është më i madh se 3, shkalla e kujdesit të treguar nga gjyqtarja në shmangien e seancave joproductive është e lartë, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet me 15 pikë.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Pas analizës së të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, aftësia e gjyqtarës për këtë tregues, është “1-3 seanca dhe/ose shkallë shumë e lartë e aftësisë”, pikëzohet me 15 pikë.

2.B.B. KRYERJA E VEPRIMEVE TË NEVOJSHME PROCEDURALE PËR ORGANIZIMIN E PROCESIT GJYQËSOR

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);

- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Në gjykimet që i përkasin dosjeve të mbyllura me një seancë të vetme në dhomë këshillimi (shih dosjet 1, 2 dhe 4), në dy prej tyre gjykimi ka filluar në orën e caktuar në urdhrin për njoftimin e palëve (shih dosjet 2 dhe 4), ndërsa në një rast gjykimi ka filluar me 3 orë vonesë dhe nuk është relatuar shkaku i vonesës (shih dosjen 1). Në dy raste ku gjykimi në dhomë këshillimi ka përfunduar me dy seanca vetëm njëra është çelur në orarin e caktuar, pasi një seancë nuk është zhvilluar për mungesë të gjyqtarëve (shih dosjet 3 dhe 5). Për seancat e dyta të këtyre çështjeve, vetëm njëra është çelur në orar në referim të urdhrin për njoftimin e palëve (shih dosjen 5), ndërsa në një rast tjetër nuk ka të dhëna në lidhje me respektimin e orarit, pasi nuk ka akt për caktimin e seancës (shih dosjen 3). Nga 7 seancat gjyqësore të vëzhguara në 3 prej tyre nuk është pasqyruar ora e mbylljes së seancës (shih dosjet 1, 3 seanca 1 dhe 5 seanca 2). Nga 7 seancat e vëzhguara rezultoi se asnjë seancë nuk është regjistruar në sistem regjistrimi audio. Për të 5 çështjet subjekti i rivlerësimit ka disponuar me urdhrin për caktimin e seancës së parë në dhomë këshillimi (në referim të seancës së parë të caktuar nga kryetari i gjykatës me shpallje - shih dosjet 3, 4 dhe 5), si dhe ka përgatitur raportimin me shkrim, referuar nën 49/2 të ligjit nr. 49/2012. Veprimet në dhomë këshillimi janë dokumentuar me procesverbal, i cili është mbajtur sipas parashikimeve të nenit 49/3 të ligjit nr. 49/2012 dhe K.Pr.Civile. Procesverbali i seancës është i firmosur në fund të fletës nga sekretarja gjyqësore dhe në fund të tij nga gjyqtarja kryesuese dhe sekretarja gjyqësore. Aktet për njoftimin e palëve, në dy raste janë bërë me dërgimin e njoftimeve palëve, ku në aktin e njoftimit është pasqyruar urdhri për njoftimin e palëve (shih dosjet 1 dhe 2). Në tre raste si akt njoftimi ka shërbyer lista e shpallur nga kryetari i gjykatës, ku në fund të saj është vënë shënimi për të drejtën e palëve për të dorëzuar parashtrimet deri në 5 ditë para datës së shqyrtimit të çështjes, në bazë të parashikimeve të nenit 49/2 të ligjit nr. 49/2012 (shih dosjet 3, 4 dhe 5)”.

- Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezultoi se:

Nga 11 çështjet e përzgjedhura me short për vlerësim, 10 (dhjetë) prej tyre janë shqyrtuar në dhomë këshillimi dhe 1 (një) çështje është shqyrtuar në seancë gjyqësore. Gjyqtarja në çdo rast i ka vënë në lëvizje çështjet, duke përgatitur relacionin përkatës, si dhe duke urdhëruar njoftimin e palëve për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara. Po kështu, gjyqtarja ka realizuar njoftimin e palëve mbi të drejtën për të paraqitur me shkrim 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes, parashtrimet e tyre lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. Seancat për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në çështjet e vëzhguara janë dokumentuar në procesverbalin e seancës, të mbajtur nga sekretarja gjyqësore. Ndërsa seancat gjyqësore përveçse janë dokumentuar me procesverbalin e mbajtur nga sekretarja gjyqësore, janë mbajtur edhe me sistemin e regjistrimit audio.

Drejtimi i seancës zhvillohet në çdo rast nëpërmjet urdhrave dhe vendimeve të ndërmjetme, të cilat janë të shoqëruara me bazën ligjore përkatëse të tyre, si dhe me arsyet e vendimmarrjes.

Në dosjet e vëzhguara, seancat e planifikuara janë çelur relativisht në kohë, me vonesa nga 2 deri në 15 minuta, që janë të papërfillshme, e që lidhen me kushtet e punës. Megjithatë, konstatohet se disa seanca kanë filluar me më shumë se 20 minuta me vonesë, deri në 3 orë me vonesë, nga ora e planifikuar, por në asnjë rast nuk konstatohet që fillimi me vonesë i seancës të jetë bërë shkak për dështimin e seancës në dhomë këshillimi, apo të seancës gjyqësore. Shkaku i vonesës në zhvillimin e seancës gjyqësore, në rastet kur ai është relatuar nga gjyqtarja, lidhet me pjesëmarrjen e saj në gjykime të tjera të përfunduara tej afatit të parashikuar, apo problemit teknik të sistemit audio.

KONKLUZIONE

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, kryerja e veprimeve të nevojshme procedurale për organizimin e procesit gjyqësor, vlerësohet bazuar ndër të tjera, edhe në shkallën e aftësisë dhe efikasitetit të treguar nga gjyqtarja në kryerjen e veprimeve për fillimin pa vonesë të seancave gjyqësore. Përgjithësisht, rezulton se shkak për fillimin me vonesë të seancave gjyqësore është bërë zgjatja e gjykimeve të mëparshme. Nga ana tjetër, duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka treguar shkallë shumë të lartë në drejtim të zhvillimit dhe dokumentimit të veprimeve procedurale, duke respektuar standardet e procesit të rregullt ligjor dhe duke ndjekur me korrektësi hapat proceduralë të gjykimit në apel administrativ, në dhomë këshillimi, apo në seancë gjyqësore.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Kryerja e veprimeve procedurale për organizimin e procesit gjyqësor” është “Shumë e lartë”, duke e pikëzuar me 20 pikë.

2.C. AFTËSIA E GJYQTARES PËR TË ADMINISTRUAR DOSJEN GJYQËSORE

2.C.A. RREGULLSHMËRIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (6 çështjet e përzgjedhura me short).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta, përveç rastit kur urdhri për njoftimin e palëve është bërë nga relatorja para datës së vendimit për caktimin e seancës (shih dosjen nr. 5) dhe nuk ka urdhër për njoftimin e palëve për seancën e radhës (shih dosjen nr. 3). Në të 5 dosjet e vëzhguara gjendet relatimi i subjektit të rivlerësimit,

i nënshkruar në fund prej tij. Në 5 dosjet gjendet urdhri për caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi. Në çdo fashikull janë përfshirë aktet e njoftimit të palëve dhe kopje të listave të gjyqimit për 3 çështje, të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe kryetari i gjykatës. Duhet evidentuar se vetëm në një rast seanca është shtyrë për shkak të mos nxjerrjes së listë shpalljes nga kryetari (shih dosjen nr. 3). Aktet e tjera të përfshira në dosje kanë qenë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji”.

Aktet e dosjeve janë renditur në mënyrë të rregullt dhe duke ndjekur përgjithësisht të njëjtën radhë të renditjes së dokumenteve. Renditja e akteve është bërë duke ndjekur rendin logjik, sipas kategorive të akteve dhe rendin kronologjik (*sipas datës së aktit*) brenda të njëjtës kategori.

Renditja e akteve fillon me aktin e shortit, vijon me relacionin e çështjes, të përgatitur nga kryesuesja e trupit gjykues, urdhrin për njoftimin e palëve ndërgjyqëse, aktet e njoftimit të palëve, procesverbalin për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, vendimin për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore (*në ato raste kur trupi gjykues ka disponuar për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë gjyqësore*), vendimin e arsyetuar për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, parashtrimet e palëve, provat e paraqitura gjatë shqyrtimit gjyqësor, procesverbalet e seancave gjyqësore dhe mbyllet me vendimin gjyqësor përfundimtar.

Brenda kategorisë, aktet renditen sipas datave (*njoftimet, procesverbalet e seancave*). Renditja e akteve në dosje, e cila është përgjithësisht e njëjtë, është bërë në mënyrë të tillë që ta bëjë dosjen gjyqësore lehtësisht të shfrytëzueshme nga subjektet dhe nga gjykata më e lartë. Dosjet paraqiten të rregullta në aspektin formal të tyre, aktet janë të numëtuara dhe mund të shfrytëzohen me lehtësi.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Rregullshmëria e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë”, pikëzohet me 5 pikë.

2. C.B. SAKTËSIA DHE PLOTËSIA E DOKUMENTACIONIT TË DOSJES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruara gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short, 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit; (*6 çështjet e përzgjedhura me short*).

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “Nga vëzhgimi i 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura me short u konstatua se përgjithësisht aktet themelore janë të rregullta, përveç rastit kur urdhri për njoftimin e palëve është bërë nga relatorja para datës së vendimit për caktimin e seancës (shih dosjen nr. 5) dhe nuk ka urdhër për njoftimin e palëve për seancën e radhës (shih dosjen nr. 3). Në të 5 dosjet e vëzhguara gjendet relatimi i subjektit të rivlerësimit, i nënshkruar në fund prej tij. Në 5 dosjet gjendet urdhri për caktimin e seancës gjyqësore në dhomë këshillimi. Në çdo fashikull janë përfshirë aktet e njoftimit të palëve dhe kopje të listave të gjyqimit për 3 çështje, të firmosura nga subjekti i rivlerësimit dhe kryetari i gjykatës. Duhet evidentuar se vetëm në një rast seanca është shtyrë për shkak të mos nxjerrjes së listë shpalljes nga kryetari (shih dosjen nr. 3). Aktet e tjera të përfshira në dosje kanë qenë të sakta dhe në përputhje me kriteret e caktuara nga ligji”.

Nga vëzhgimi i dosjeve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, për saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të dosjes, rezulton se në dosje ndodhen të gjitha aktet e hartuara nga gjykata (njoftimet, procesverbalet e çdo seancë për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi apo për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, vendimet gjyqësore), si dhe aktet e paraqitura nga palët (parashtrimet, prapësimet e palëve).

Nuk rezultojnë mungesa të dokumentacionit në dosjet e vëzhguara, apo prania e akteve apo dokumenteve që nuk i përkasin çështjes konkrete.

KONKLUZIONE

Duke iu referuar burimeve të vlerësimit, rezulton se gjyqtarja ka shkallë aftësie shumë të lartë në këtë tregues.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Saktësia dhe plotësia e dokumentacionit të dosjes” është “Shumë e lartë”, pikëzohet me 10 pikë.

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin e “Aftësive organizative të gjyqtares”

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
AFTËSITË ORGANIZATIVE TË GJYQTARES	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

3. ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE

Vlerësimi i kriterit të etikës dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale bëhet duke u bazuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, ka etikë, integritet dhe shfaq paanësi në funksion. Pikëzimi për treguesit e këtij kriteri bëhet në rend zbritës, dhe çdo gjyqtar

e fillon procesin e vlerësimit me totalin e pikëve referuar këtij kriteri vlerësimi, duke zbritur sipas rastit pikët në varësi të problematikave të shfaqura në lidhje me çdo tregues sipas burimeve të vlerësimit.

3.A. ETIKA NË PUNË

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren {...} përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë mase disiplinore”.*

3.A.A. ANGAZHIMI DHE PËRGJEGJSHMËRIA NË FUNKSION

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave.

Referuar raportit për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit me nr.3158/3 Prot., datë 08.04.2019 rezulton se 7 (shtatë) ankesa janë verifikuar dhe regjistruar: 3 (tre) për mosrespektim formal të ligjit, 3 (tre) për mosdorëzimin në afat të vendimeve të arsyetuara, 1 (një) për mospërdorimin e sistemit audio.

Referuar akteve të dosjes së rivlerësimit, si dhe dosjes personale të gjyqtarës {...}, nuk rezulton që gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, të jetë dhënë apo zbatuar masë disiplinore ndaj saj.

Në relacionet e hartuar nga Inspektorati i KLD, si dhe në vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nr.522/2 Prot., datë 12.05.2021, nr. 379/2 Prot., datë 04.02.2022, dhe nr.259/4 Prot., datë 28.02.2022, nuk rezulton të jenë evidentuar elementë që të dëshmojnë shfaqje e sjellje që tregojnë mungesë respekti për palët dhe pjesëmarrësit në gjykim, mungesë vetëpërmbytjeje, ndjeshmërie, vëmendjeje, apo prania e sjelljeve dhe qasjeve të pahijshme dhe ofensive nga ana e gjyqtarës.

Në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 281, datë 27.07.2020, rezulton se KPK ka shqyrtuar dhe vlerësuar elementë lidhur me etikën e gjyqtarës, sa i përket denoncimit të shtetasës J.B lidhur me sjelljen joetike të treguar në adresë të saj. KPK është shprehur se *“Trupi gjykues, lidhur me pretendimet e denoncuesit në raport me shpjegimet e dhëna nga subjekti në vlerësim të fakteve dhe të rrethanave, çmon se: a) shpjegimet e dhëna nga subjekti duket se referojnë të dhëna që janë pasojë e një marrëdhënieje me problematika në punë, mes saj dhe denoncueses në pozicionin e ndihmëses ligjore; b) faktet e dala nga provat e administruara tregojnë përpjekjet maksimale të subjektit mbi ndërmarrjen prej*

saj të një sërë veprimesh për adresimin e këtyre problematikave në organet më të larta dhe kompetente për marrjen e masave, duke përmendur këtu edhe vendimin nr. 57/13 prot., datë 04.12.2018, të inspektimit nga Këshilli i Lartë i Drejtësisë”.

Në përfundim lidhur me këtë denoncim në vendimin e KPK është konkluduar se *“Në vlerësimin tërësor të rrethanave të paraqitura, trupi gjykues konkludon se pavarësisht rrethanave të krijuara në dukje konfliktuale mes tyre, pasi analizoi shpjegimet e subjektit dhe e dëgjoi në seancë dëgjimore, çmon se subjekti, si magjistrate në sistemin e drejtësisë, duhet të evitohet çdo fjalor joetik, pavarësisht rrethanës që e dikton, pasi ajo duhet të demonstrojë sjellje që i shërben figurës së magjistratit”.*

Referuar akteve burim vlerësimi, rezulton se në datën 08.02.2018 në KPK është regjistruar ankesa me nr.1672 prot., me ankuese shtetasen J.B., në të cilën ngrihen pretendime për shkelje të etikës gjyqësore nga gjyqtarës {...}, gjatë ushtrimit të detyrës së saj në raport me ndihmesën ligjore. Këto pretendime të ankueses lidhur me fjalët e përdorura nga ana e gjyqtarës {...} në adresë të saj, janë shoqëruar me kopje të fletëve përkatësve të akteve (projektvendimeve/relacioneve), që sipas ankueses janë hartuar prej saj në cilësinë e ndihmësit ligjor dhe i përkasin periudhës prill 2017, korrik 2017, nëntor 2017 dhe dhjetor 2017. Në kushtet kur faktet e referuara i përkasin vitit 2017, kjo çështje mund të trajtohet në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarës, për periudhën e vlerësimit që përfshin vitin 2017.

Gjithashtu, rezulton se të njëjtat pretendime, ankuesja i ka parashtruar edhe në ankesën e paraqitur prej saj në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, regjistruar me nr.459 Prot., datë 02.02.2018, për të cilën KLD me vendimin nr.459/12 Prot., datë 01.11.2018 ka vendosur *“Pezullimin e hetimit disiplinor ndaj gjyqtarës {...} të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë deri në marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit Tiranë në lidhje me ankimimin e vendimit gjyqësor nr.1402, datë 09.05.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për të konkluduar më pas në lidhje me hetimin disiplinor të iniciuar për këtë rast. Pezullimi i hetimit disiplinor ndërpret afatet e procedimit të parashikuar nga neni 118 i ligjit nr.96/2016...”*

Sa më sipër, në kushtet kur faktet dhe rrethanat e referuara në aktet e dosjes së rivlerësimit, nuk i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016, nuk mund të përbëjnë burim vlerësimi për këtë periudhë vlerësimi pasi sipas parashikimeve të nenit 77, shkronja dh) të Ligjit për Statusin, konsiderohen burim vlerësimi të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja reflekton angazhim dhe përgjegjshmëri në funksion dhe nuk rezulton të ketë sjellje që mund të cenojë etikën në punë të saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të angazhimit dhe përgjegjshmërisë në funksion.

Shkalla e etikës në punë të gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e etikës së gjyqtares në treguesin “Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 35 pikë.

3.B. INTEGRITETI I GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit {...} dhe nga 5 dosjet e vëzhguara konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e saj ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm”.*

3.B.A. SHMANGIA E SHFAQJES SË PAHIJSHME, NDERI DHE DINJITETI

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat nga burime arkivore të KLGJ/KLD;
- Të dhënat për masa disiplinore;
- Rezultatet e verifikimit të ankesave;
- Konkluzionet e raportit të ILDKPKI pasqyruar në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit dhe konkluzionet e arritura në vendimin e formës së prerë të organeve të rivlerësimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë.

- ***Nga analiza e burimeve të vlerësimit lidhur me këtë tregues, rezulton se:***

Referuar të dhënave nga burimet arkivore të KLD dhe dokumentacionit të administruar në dosjen e rivlerësimit, nuk rezulton që ndaj gjyqtares {...}, në periudhën e vlerësimit, të jenë marrë ose zbatuar masa disiplinore.

Sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezulton se gjatë periudhës tre vjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013 - 8 tetor 2016”, për gjyqtaren {...} janë paraqitur gjithsej 9 (nëntë) ankesa në Inspektoratin e KLD. Në materialet për verifikimin e ankesave rezulton se nuk janë konstatuar të dhëna që të dëshmojnë shfaqjen e sjelljeve që tregojnë mungesë integriteti të gjyqtares, shfaqje të pahijshme, shfaqje që cenojnë nderin, dinjitetin dhe pritshmërinë e publikut.

Nga vendimin e KPK, lidhur me vlerësimin e kriterit pasuror, pas vlerësimit të raportit të ILDKPKI dhe hetimit administrativ të kryer nga KPK, konkludohet se *“Në përfundim, lidhur me kriterin e pasurisë, trupi gjykues mbi konstatimet e: (i) diferencave në vlera të vogla të shtrira ndër vite; (ii) rrethanave të përdorimit të automjetit, duke vënë në balancë pasojat e tyre, në raport me vlerësimin tërësor të procesit të kontrollit të pasurisë, në referencë të parashikimeve ligjore të nenit 51 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe*

*objektivitetit, çmon se nuk janë të mjaftueshme për aplikimin e ndonjë mase disiplinore në kuptim të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016”.*²⁸

Në të njëjtën kohë, në procesin e rivlerësimit kalimtar, referuar vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 281, datë 27.07.2020, janë shqyrtuar dhe vlerësuar elementë në lidhje me integritetin e gjyqtarës, të cilët pasi janë analizuar në kuadër të vlerësimit figurës, janë gjetur të pabazuara duke konkluduar se: *“Nuk vërtetohen dyshimet mbi përfshirje në veprimtari korruptive në pozicionin e anëtarës së trupit gjykues për çështjen e referuar, shpjegimet e saj ishin bindëse, si dhe ka plotësuar me saktësi dhe vërtetësi deklaratën e kontrollit të figurës sipas parashikimeve ligjore të kreut V të ligjit nr. 84/2016, duke konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës”.*²⁹

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit, nuk rezulton asnjë e dhënë apo element që të dëshmojë shfaqje të pahijshme apo cenim të nderit dhe dinjitetit të gjyqtarës.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja gëzon integritet të lartë. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të integritetit, si dhe nuk rezulton asnjë e dhënë për sjellje të pahijshme, apo sjellje që cenojnë nderin dhe dinjitetin e saj.

Shkalla e integritetit të gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e integritetit të gjyqtarës në treguesin “Shmangia e shfaqjes së pahijshme, nderi dhe dinjiteti” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 40 pikë.

3.C PAANËSIA E GJYQTARES

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se *“Nga 3 dokumentet ligjore të paraqitura nga vete subjekti dhe nga 5 dosjet e vëzhguara nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit {...}. Për vete gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve. Nga ana tjetër, asnjë prej 3 dokumenteve ligjore dhe 5 dosjeve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Në 3 dokumentet ligjore dhe në aktet e 5 dosjeve të vëzhguara nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të venë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Po ashtu nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit {...} nuk ka respektuar rregullat procedurale”.*

²⁸ Faqe 45 e vendimit të KPK nr. 281, datë 27.07.2020.

²⁹ Faqe 53 e vendimit të KPK nr. 281, datë 27.07.2020.

3.C.A. PËRDORIMI OSE JO I GJUHËS DISKRIMINUESE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit, duke përfshirë dhe regjistrimet audio të seancave (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të dorëzuara nga gjyqtarja dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short për vlerësim, nuk rezulton në asnjë rast përdorimi i gjuhës diskriminuese nga gjyqtarja në komunikimin me palët ndërgjyqëse gjatë zhvillimit të seancave, apo në përmbajtje të vendimeve përfundimtare të saj. Gjithashtu, nuk ka asnjë të dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese me të tretët, referuar komunikimit shkresor dhe akteve përkatëse të administruara në dosjet e gjykimit.

Nga tërësia e burimeve të vlerësimit nuk rezulton asnjë e dhënë për përdorim të gjuhës diskriminuese nga ana e gjyqtares.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja në asnjë rast nuk ka përdorur gjuhë diskriminuese, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, në komunikimin me subjektet e procedimit ose në përmbajtjen e vendimeve të hartuara prej saj. Për këto arsye, për këtë tregues rezulton se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të aftësisë për të shmangur përdorimin e gjuhës diskriminuese.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shmangia e përdorimit të gjuhës diskriminuese” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.

3.C.B NUMRI TEJET I LARTË I KËRKESAVE TË PRANUARA TË PALËVE PËR PËRJASHTIMIN E GJYQTARES

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat statistikore.

Në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, lidhur me këtë tregues, konkludohet se “...Për vetë gjyqtaren {...} në asnjë prej 5 dosjeve të vëzhguara nuk ka patur kërkesa për përjashtimin e saj nga gjykimi i çështjeve....”.

Referuar të dhënave statistikore të administruara në dosjen e rivlerësimit, nuk rezultojnë të dhëna për numrin e kërkesave për përjashtim apo për numrin e kërkesave për heqje dorë të gjyqtares, pasi kjo e dhënë nuk është kërkuar në formatin standard mbi të cilin janë raportuar të dhënat statistikore. Nga burimet e tjera (burimet arkivore të KLD/KLGJ) si dhe tërësia e akteve të administruara në dosjen e vlerësimit, nuk ka të dhëna për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares në periudhën e vlerësimit. Duke iu referuar tërësisë së akteve të administruara në dosjen e vlerësimit (11 dosjet e përzgjedhura me short për vlerësim dhe 3 vendimet e përzgjedhura nga gjyqtarja) nuk rezultojnë të dhëna që në këto çështje të jenë paraqitur kërkesa për përjashtimin e gjyqtares. Në këto kushte, duke referuar në parimin kushtetues që çdo gjyqtar, për shkak të statusit të tij, është dhe duhet të shfaqë paanësi në funksion, në mungesë të të dhënave burimore për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, në kushtet kur në rastet e gradimit zbatohen për aq sa është e mundur dispozitat e Ligjit për Statusin, vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares është i pakonsiderueshëm.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se nuk ka asnjë të dhënë për ekzistencën e një numri tejet të lartë të kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares. Prandaj, për këtë tregues vlerësoj se numri i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares, duhet të vlerësohet si i pakonsiderueshëm.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Numri tejet i lartë i kërkesave të pranuar të palëve për përjashtimin e gjyqtares” është “I pakonsiderueshëm”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale”

Propozim për nivelin e vlerësimit	
KRITERI	
ETIKA DHE ANGAZHIMI NDAJ VLERAVE PROFESIONALE	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	100

4. AFTËSIA PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL

Në këtë kriter vlerësohet kapaciteti personal dhe angazhimi profesional i gjyqtares {...} në drejtim të aftësive të komunikimit, bashkëpunimit dhe angazhimit ndaj vlerave profesionale.

4.A AFTËSIA E KOMUNIKIMIT

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 5 dosjet gjyqësore të vëzhguara, në procesverbalin gjyqësor në format letër, nuk ka të dhëna për mënyrën direkte të komunikimit të subjektit {...} me palët ndërgjyqëse, pasi këto çështje janë shqyrtuar në dhomë këshillimi pa pjesëmarrjen e palëve, megjithëse në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues i seancës gjyqësore. Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara, gjuha e përdorur në akte është normale, komunikimi në përputhje me etiken gjyqësore dhe i qartë”.

4.A.A. KOMUNIKIMI I QARTË DHE TRANSPARENT

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjor të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (6 dosjet e përzgjedhur me short).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short (kryesisht procesverbaleve të seancave të zhvilluar në çështjen e shqyrtuar në seancë gjyqësore, komunikimet shkresore me të tretët dhe vendimeve gjyqësore) rezulton se gjyqtarja gjatë komunikimit me palët dhe pjesëmarrësit në proces është e qartë, transparente, e kuptueshme. Në rastet e ndërhyrjeve të gjyqtares për të qartësuar kërkimet e palëve apo për të orientuar debatin gjyqësor, vërehet se komunikimi i saj është i drejtpërdrejtë dhe konkret, në lidhje me çështjen për të cilën pyeten palët ose përfaqësuesit e tyre. Gjithashtu, evidentohet komunikim i qartë, i saktë dhe konciz gjatë zhvillimit të seancave gjyqësore, duke e bërë procesin të kuptueshëm për palët dhe për pjesëmarrësit në të. Të njëjtat cilësi rezultojnë edhe në arsyetimin e vendimeve përfundimtare, ku gjuha e përdorur është e thjeshtë, e kuptueshme, e qartë, koncize dhe e drejtpërdrejtë. Në aktet shkresore drejtuar të tretëve është përdorur gjuhë e drejtpërdrejtë dhe koncize, duke respektuar normat e komunikimit zyrtar.

KONKLUZIONE

Në tërësi, referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, rezulton se gjyqtarja ka komunikim të qartë dhe transparent me pjesëmarrësit në gjykim, si dhe në gjuhën e përdorur në arsyetimin e vendimeve.

Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtares në treguesin “Komunikimi i qartë dhe transparent” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 25 pikë.

4.A.B. RESPEKTIMI I KONFIDENCIALITETIT DHE MBROJTJES SË TË DHËNAVE PERSONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, të administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dokumentet ligjore të administruar gjatë procesit të rivlerësimit (*5 dosjet e përzgjedhura me short dhe 3 vendimet e paraqitura nga gjyqtarja*);
- Aktet e çështjeve të përzgjedhura me short pas fillimit të procedurës së vlerësimit (*6 dosjet e përzgjedhur me short*).

Referuar 3 vendimeve gjyqësore të përzgjedhura nga gjyqtarja për vlerësim dhe akteve të 11 çështjeve të përzgjedhura me short, nuk rezulton asnjë e dhënë për cenim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale të subjekteve të procedimit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton asnjë e dhënë për mosrespektim të konfidencialitetit apo të të dhënave personale dhe për rrjedhojë, prezumohet se gjyqtarja ka treguar kujdes maksimal për ruajtjen e konfidencialitetit dhe mbrojtjen e të dhënave personale të palëve apo subjekteve të procedimit, për të cilat ka ardhur në dijeni për shkak të funksionit.

***Respektimi i konfidencialitetit nga gjyqtarja dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Respektimi i konfidencialitetit dhe mbrojtjes së të dhënave personale” është “I lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.*

4.B. AFTËSIA PËR TË BASHKËPUNUAR

Lidhur me këtë nën kriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Në 3 dokumentet ligjore dhe në 5 dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit {...} për të bashkëpunuar me koleget dhe administratën gjyqësore, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta. Në të gjitha rastet subjekti i rivlerësimit ka qenë kryesues dhe përgjithësisht ka bashkëpunuar me administratën gjyqësore për të zhvilluar seancën sipas rregullave procedurale të parashikuara në ligjin nr. 49/2012. Në një rast nuk ka pasur bashkëpunimin e duhur me drejtuesin e gjykatës dhe administratën për të parandaluar shtyrjen e seancës gjyqësore për shkak të mos nxjerrjes së listë shpalljes edhe pse kjo është detyrë e kryetarit të gjykatës. Në 2 prej 5 dosjeve të vëzhguara është konstatuar se bashkëveprimi me anëtarët e trupit gjykues dhe administratën gjyqësore përgjithësisht ka qenë në nivelin e duhur, pasi nuk janë konstatuar vonesa domethënëse në depozitimin e dosjes në sekretarinë gjyqësore (shih dosjet 1 dhe 3), ndërsa në tre raste të tjera ky bashkëpunim nuk ka qenë

nivelin e duhur, pasi janë konstatuar vonesa domethënëse në dorëzimin e dosjeve me vendimin e arsyetuar (shih dosjet 2, 4 dhe 5)”.

4.B.A. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME KOLEGËT, DUKE PËRFSHIRË SHKËMBIMIN E NJOHURIVE DHE PËRVOJËS PROFESIONALE ME TA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtarës gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burime vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, shërbejnë edhe vetëvlerësimi i gjyqtarës dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarës (gradimin), dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për pasojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për mungesë të bashkëpunimit me kolegët, për rrjedhojë, prezumohet se ky komunikim është në nivel të lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, nuk rezulton asnjë e dhënë ose indicie për mungesë të bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, gjatë periudhës së vlerësimit. Për pasojë, në mungesë të të dhënave që mund të rezultonin nga dy burimet e tjera të vlerësimit dhe mungesës të ndonjë të dhëne të drejtpërdrejtë apo të tërthortë për mungesën e bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se ky bashkëpunim ekziston dhe është në nivel shumë të lartë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtarës me kolegët, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

Shkalla e aftësisë së gjyqtarës dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, shkalla e aftësisë së gjyqtarës në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me kolegët, duke përfshirë shkëmbimin e njohurive dhe përvojës profesionale me ta” është “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 15 pikë.

4.B.B. SHKALLA E KOMUNIKIMIT DHE BASHKËPUNIMIT ME ADMINISTRATËN GJYQËSORE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj gjyqtares gjatë periudhës së vlerësimit.

Referuar Metodologjisë së Pikëzimit, si burim vlerësimi për këtë tregues, veç të dhënave për verifikimin e ankesave, është dhe vetëvlerësimi i gjyqtares dhe mendimi i kryetarit. Në rastin konkret, në procedurën e vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtares (gradimin) dy nga burimet e vlerësimit për këtë tregues mungojnë. Për rrjedhojë, vlerësimi dhe pikëzimi për këtë kriter do të bëhet duke iu referuar dy burimeve të tjera, si dhe prezumimit se mungesa e ankesave apo të dhënave për shkallën e komunikimit me administratën gjyqësore dhe mungesën e bashkëpunimit, prezumohet se komunikimi dhe bashkëpunimi me administratën gjyqësore është shumë i lartë.

Nga të dhënat mbi verifikimin e ankesave, rezulton se në vendimin e KPK është verifikuar dhe analizuar ankesa e paraqitur nga shtetasja J.B, e cila gjatë ushtrimit të detyrës si ndihmëse ligjore në Gjykatën e Administrative të Apelit, me urdhrin nr. 225 Prot., datë 01.07.2016 të Kryetarit të Gjykatës, është caktuar për të punuar pranë gjyqtares {...}. Lidhur me këtë ankesë, sikurse i analizuar më sipër në treguesin 3.A.a “*Angazhimi dhe përgjegjshmëria në funksion*”, faktet e referuara i përkasin vitit 2017, dhe për pasojë kjo çështje mund të trajtohet në kuadër të procesit të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtares, për periudhën e vlerësimit që përfshin vitin 2017.

Sa më sipër, në kushtet kur faktet dhe rrethanat e referuara në aktet e dosjes së rivlerësimit, nuk i përkasin periudhës së vlerësimit 2013-2016, nuk përbëjnë burim vlerësimi për këtë periudhë vlerësimi pasi sipas parashikimeve të nenit 77, shkronja dh) të Ligjit për Statusin, konsiderohen burim vlerësimi të dhënat për verifikimin e ankesave të paraqitura ndaj magjistratit gjatë periudhës së vlerësimit.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, dhe mungesës së të dhënave për shkallën e komunikimit dhe bashkëpunimit të gjyqtares me administratën gjyqësore, prezumohet se gjyqtarja ka shkallë shumë të lartë të komunikimit dhe bashkëpunimit me ta.

***Shkalla e aftësisë së gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, aftësia e gjyqtares në treguesin “Shkalla e komunikimit dhe bashkëpunimit me administratën gjyqësore” duhet të vlerësohet “Shumë e lartë”, dhe pikëzohet me 10 pikë.*

4.C. GATISHMËRIA E GJYQTARES PËR T’U ANGAZHUAR NË VEPRIMTARI TË TJERA.

Lidhur me këtë nënkriter në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar, konkludohet se “Për shkak të funksionit të gjyqtarit të shkallës së

dytë (administrative) që kryen, ajo i nënshtrohet detyrimisht programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, por në periudhën e rivlerësimit, ajo nuk ka marrë pjesë në asnjë aktivitet trajnues të organizuar nga Shkolla e Magjistraturës”.

4.C.A. PJESËMARRJA E GJYQTARES NË PROGRAMET E FORMIMIT VAZHDIES TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS DHE NË TRAJNIME TË TJERA PROFESIONALE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Të dhënat e marra nga Shkolla e Magjistraturës;
- Të dhëna nga dosja personale e gjyqtares.

Referuar burimeve të vlerësimit për këtë tregues, si dhe akteve të dorëzuara nga gjyqtarja nëpërmjet postës elektronike, në datën 15.02.2022, evidentohet se gjatë periudhës së vlerësimit, gjyqtarja {...} nuk ka marrë pjesë në aktivitete trajnuese në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, por rezultojnë të ketë marrë pjesë në aktivitete profesionale jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, konkretisht, në trajnimin e organizuar nga UNCTAD (*United Nations Conference on Trade and Development*), me temë “Ligji evropian. Konkurrenca”, në datat 17-18 dhjetor 2015 dhe në trajnimin e organizuar nga misioni EURALIUS, me temë lidhur me Kodin e Procedurave Administrative, në datën 10.09.2015, që konsistojnë në 2 (dy) aktivitete trajnuese të zhvilluara në gjithë periudhën e vlerësimit, gjithsej 3 ditë trajnimi.

Lidhur me pjesëmarrjen në aktivitete trajnuese, ligji nr. 9877, datë 18.02.2018 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në fuqi në periudhën e vlerësimit, nuk përmbante një parashikim lidhur me detyrueshmërinë e pjesëmarrjes së gjyqtarit në aktivitete trajnuese. Ndërkohë, ky detyrim parashikohet në nenin 23 të ligjit nr.8316/1999 “Për Shkollën e Magjistraturës”, i ndryshuar, sipas të cilit *gjyqtarët dhe prokurorët e gjykatave e të prokurorive të shkallës së parë dhe të gjykatave të apeleve i nënshtrohen formimit vazhdues. Periudha e formimit vazhdues nuk duhet të kalojë më shumë se 20 ditë në vit dhe jo më shumë se 60 ditë gjatë pesë vjetëve.*

Aktualisht, në ligjin nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 5 të tij, pjesëmarrja në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës është përcaktuar si e drejtë dhe njëkohësisht detyrim i gjyqtarit, duke përcaktuar edhe kufirin minimal dhe maksimal të pjesëmarrjes gjatë një viti, si dhe gjatë pesë viteve.³⁰ Në

³⁰ Në nenin 5 të Ligjit nr. 96/2016, parashikohet se : “1. Magjistrati ka të drejtë dhe detyrimin të marrë pjesë në programet e formimit vazhdues. Magjistrati ka të drejtë të propozojë tema trajnimi dhe të bashkëpunojë me Këshillin, me qëllim përmirësimin e programeve të trajnimit. 2. Magjistrati duhet: a) të ndjekë formimin vazhdues, në përputhje me legjislacionin në fuqi; b) të marrë çdo masë tjetër të arsyeshme për t’u përditësuar me ndryshimet legjislative dhe të jurisprudencës. 3. Periudha e formimit vazhdues duhet të jetë: a) jo më pak se pesë ditë të plota në vit dhe jo më pak se 30 ditë të plota gjatë pesë viteve; b) jo më shumë se 40 ditë në vit dhe 200 ditë gjatë pesë viteve. 4. Magjistrati duhet të përmbushë detyrimin për të marrë pjesë në formimin vazhdues vetëm në ato raste

Metodologjinë e Pikëzimit, lidhur me këtë tregues përcaktohet se gjyqtarët kanë detyrimin ligjor të ndjekin programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës. Gjyqtari duhet t'i kushtojë kohë evoluimit të mendimit juridik dhe jurisprudencës dhe të ndjekë programe trajnimi që nxitin specializimin e tij, të organizuara edhe nga institucione të tjera trajnimi, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar, të njohura nga Këshilli.

Në lidhje me pikëzimin e aftësisë së gjyqtarit për t'u angazhuar në veprimtari të tjera, treguesi i pjesëmarrjes në programin e formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, matet duke u bazuar në informacionin me shkrim që përcillet nga Shkolla e Magjistraturës, i cili vërteton pjesëmarrjen dhe përfshirjen e magjistratit në trajnime. Pjesëmarrja e gjyqtarit në trajnime të tjera vlerësohet bazuar në dokumente të dorëzuara prej tij, që tregojnë ngritjen profesionale. Referuar sa më sipër, pavarësisht se ligji nr. 96/2016 dhe Metodologjia e Pikëzimit e miratuar me vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, të Këshillit të Lartë Gjyqësor, nuk kanë qenë në fuqi në periudhën e vlerësimit 2013-2016, referuar nenit 23 të ligjit nr. 8316/1999 "Për Shkollën e Magjistraturës", i ndryshuar, sipas formulimit të tij në periudhën e vlerësimit, rezulton se pjesëmarrja e gjyqtarit në Programin e Formimit Vazhdues të Shkollës së Magjistraturës ka qenë e rregulluar nga ky ligj, duke përcaktuar vetëm kufirin maksimal të angazhimit për 1 dhe 5 vjet dhe jo një detyrim minimal pjesëmarrjeje.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, referuar të dhënave lidhur me angazhimin e gjyqtarës {...} në aktivitete trajnuese brenda ose jashtë programit të formimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, gjatë periudhës së vlerësimit 2013-2016, pikëzimi për këtë tregues, referuar Metodologjisë së Pikëzimit, do të jetë me 20 pikë, meqenëse për periudhën 3 vjeçare rezulton pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime të tjera profesionale në 3 (tre) ditë. Kjo, pasi legjislacioni i kohës parashikonte vetëm kufirin maksimal të pjesëmarrjes në aktivitete trajnuese, por jo një kufi minimal pjesëmarrjeje në aktivitete trajnuese, sikurse përcaktohet aktualisht në nenin 5, të ligjit 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, duke marrë në konsideratë frekuencën e angazhimit të gjyqtarës në aktivitete trajnuese, sipas të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit, akteve të dorëzuara nga gjyqtarja, si dhe në kuadrin ligjor dhe nënligjor në fuqi në periudhën e vlerësimit, vlerësoj se gjyqtarja duhet të pikëzohet me 20 pikë.

***Pjesëmarrja e gjyqtarës në trajnime dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, pjesëmarrja e gjyqtarës në aktivitetet trajnuese të Shkollës së Magjistraturës dhe trajnime të tjera profesionale, dhe pikëzohet me 20 pikë.*

4.C.B. DISPONUESHMËRIA E GJYQTARES PËR TË UDHËHEQUR KANDIDATËT PËR GJYQTARË GJATË STAZHIT PROFESIONAL DHE/OSE PËR TRAJNIMIN E GJYQTARËVE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Informacioni i marrë nga SH.M ose institucione të tjera për përfshirjen e gjyqtares në veprimtari trajnuese.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklaramit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në programin e formimit vazhdues së Shkollës së Magjistraturës në cilësinë e lehtësuese/ekspertes. Nuk rezultojnë të dhëna të tjera për përfshirjen e saj në aktivitete trajnuese të organizuara nga institucione të tjera. Lidhur me disponueshmërinë e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtar gjatë stazhit profesional, nuk rezultojnë të dhëna.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij treguesi, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtares, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, për gjyqtaren {...}, duke qenë se nuk rezultojnë të dhëna, ky tregues pikëzohet me 3 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të jetë angazhuar në aktivitete trajnuese si eksperte/lektore dhe as angazhimi i saj për udhëheqjen e kandidatëve për gjyqtarë gjatë vitit të stazhit profesional.

Disponueshmëria e gjyqtares dhe pikëzimi: Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Disponueshmëria e gjyqtares për të udhëhequr kandidatët për gjyqtarë gjatë stazhit profesional dhe/ose për trajnimin e gjyqtarëve”, dhe pikëzohet dhe pikëzohet me 3 pikë.

4.C.C. ANGAZHIMI I GJYQTARES NË VEPRIMTARI NDËR-INSTITUCIONALE PËR PËRMIRËSIMIN E DREJTËSISË DHE NË VEPRIMTARI PËR MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN NË GJYKATA

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;

- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja për periudhën e vlerësimit 2013 – 2016 të jetë angazhuar në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë apo veprimtari të tjera, të tilla si: pjesëmarrje në konferenca shkencore, mësimdhënie, fjalime publike, pjesëmarrje në aktivitete të edukimit të komunitetit, kontribute për hartimin dhe ndryshimin e legjislacionit, etj.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit që përcakton se për pikëzimin e këtij kriteri, duke marrë parasysh që pjesëmarrja në veprimtari të tilla, jo gjithmonë është në varësi të vullnetit të gjyqtarit, të gjithë gjyqtarët do ta fillojnë vlerësimin për këtë tregues me 3 pikë dhe 2 pikë do t'u shtohen në rast vërtetimit të angazhimit në këto veprimtari, vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 3 pikë.

***Pjesëmarrja, kontributi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, në treguesin “Angazhimi i gjyqtares në veprimtari ndërinstitucionale për përmirësimin e drejtësisë dhe në veprimtari për marrëdhëniet me publikun në gjykata”, gjyqtarja vlerësohet dhe pikëzohet me 3 pikë.*

4.C.Ç. PUBLIKIMET LIGJORE AKADEMIKE

Si burime vlerësimi për këtë tregues shërbejnë:

- Konkluzionet e arritura në lidhje me këtë tregues në Raportin për analizimin e aftësive profesionale, administruar në dosjen e rivlerësimit kalimtar;
- Dosja personale e gjyqtares;
- Çdo e dhënë tjetër që tregon për angazhime të kësaj natyre.

Referuar burimeve të vlerësimit si më sipër, si dhe formularit të deklarimit për aftësitë profesionale të gjyqtares, nuk rezulton që gjyqtarja gjatë periudhës së vlerësimit të ketë realizuar publikime ligjore akademike, me qëllim dhënien e kontributit për zhvillimin e doktrinës.

Bazuar në sa parashtrohet më sipër, duke iu referuar Metodologjisë së Pikëzimit vlerësoj se për gjyqtaren {...} ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

KONKLUZIONE

Referuar të dhënave që rezultojnë nga burimet e vlerësimit për këtë tregues, nuk rezulton që gjyqtarja të ketë realizuar publikime ligjore akademike në periudhën vlerësimit dhe për pasojë, ky tregues duhet të pikëzohet me 0 pikë.

***Angazhimi i gjyqtares dhe pikëzimi:** Bazuar në sa parashtrohet më sipër, vlerësoj se në treguesin “Publikime ligjore akademike” nuk rezulton angazhimi i gjyqtares, prandaj gjyqtarja duhet të vlerësohet dhe pikëzohet me 0 pikë.*

Niveli i vlerësimit dhe pikëzimi për kriterin “Aftësitë personale dhe angazhimi profesional”

Propozim për nivelin e vlerësimit KRITERI AFTËSITË PERSONALE DHE ANGAZHIMI PROFESIONAL	
Niveli i vlerësimit	Pikët
Shkëlqyeshëm	91

F- PROPOZIMI PËR NIVELIN E VLERËSIMIT PËR ÇDO KRITER VLERËSIMI DHE NIVELIN E PËRGJITHSHËM TË VLERËSIMIT

Propozim për nivelin e vlerësimit për çdo kriter		
Kriteri	Pikët	Niveli i vlerësimit
1. Aftësitë profesionale të gjyqtares	100	Shkëlqyeshëm
2. Aftësitë organizative të gjyqtares	91	Shkëlqyeshëm
3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale	100	Shkëlqyeshëm
4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional	91	Shkëlqyeshëm
Propozim për nivelin e përgjithshëm të vlerësimit		
Vlerësimi i përgjithshëm	382	Shkëlqyeshëm